



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2021

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.06.2021)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, i gjyqtarit { ...}”, relatore znj. Brunilda Kadi.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:05 dhe mbaroi në orën 13:50.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)

10. Marçela Shehu (anëtare)

11. Erjon Muharremaj (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Aleksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 6. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
- 7. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, i gjyqtarit {...}”, relatore znj. Brunilda Kadi.

Naureda Llagami: Përshëndetje!

Po fillojmë mbledhjen e radhës së datës 9 qershor 2021.

Siç jeni në dijeni, në rendin e ditës sot janë 9 çështje që do merren në shqyrtim nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Çështja e parë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, i gjyqtarit {...}”.

Çështja e dytë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional, të gjyqtarit {...}, për vitin 2019”, relator z. Erjon Muharremaj.

Çështja e tretë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të katër kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar,

për pozicionin e lirë të shpallur nga Këshilli i lartë Gjyqësor dhe verifikimin e kritereve të tjera ligjore të kandidimit.

Çështja e katërt ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të katër kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur ngatë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Çështja e pestë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për skualifikimin e kandidates znj. {...} dhe përjashtimin e saj nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë”.

Çështja e gjashtë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për skualifikimin e kandidates znj. {...} dhe përjashtimin e saj nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë”.

Çështja e shtatë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për dhënie leje të papaguar gjyqtares {...}”.

Çështja e tetë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për komandimin e gjyqtares znj. {...} në Këshillin e Lartë Gjyqësor”.

Çështja e nëntë ka të bëjë me dy projektvendime: Së pari, “Për caktimin në Skemën e Delegimit të gjyqtarit z. {...}”; dhe “Për caktimin e gjyqtarit të Skemës së Delegimit z. {...} në Gjykatën e Apelit Shkodër”.

Jeni dakord me rendin e ditës?

Nëse s’kemi kundërshtime, atëherë kalojmë në shqyrtimin e çështjes së parë.

Siç jeni në dijeni, Këshilli është në vijimin e shqyrtimit të vlerësimeve për kandidatët që janë në Gjykatën e Lartë. Kështu që sot do marrim në shqyrtim dy vlerësime për kandidatin zotin {...}. Kemi të bëjmë me vlerësimin e parë, që relatore do jetë zonja Kadi dhe më pas, për vlerësimin e 2019-ës relator do jetë Erjon Muharremaj. Në të dyja këto vlerësime, kandidati ka parashtruar kundërshtime por nuk ka kërkuar që të jetë prezent në seancë dëgjimore, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Për më shumë detaje fjalën ia jap zonjës Kadi.

Brunilda Kadi: Faleminderit, Kryetare!

Në lidhje me projektraportin e vlerësimit profesional me qëllim gradimi për vitet 2013-2016 të gjyqtarit {...}, i cili aktualisht ushtron funksionin në Gjykatën e Apelit Tiranë, siç jeni njohur kohë më përpara me projektraportin dhe me aktet mbi të cilat është bazuar realizimi i tij, është bërë nga ana ime propozimi i vlerësimit të tij sipas treguesve si më poshtë. Për të qenë më eficient unë do të lexoj konkluzionet për çdo tregues dhe do ndalem aty ku gjyqtari ka bërë kundërshtimet, me të cilat jeni njohur, dhe në fund do parashtoj vlerësimin tim në lidhje me ndryshimet që besoj se duhen bërë.

Në lidhje me grupkriterin e “Aftësive profesionale të gjyqtarit”, që përbëhet nga 5 tregues që janë: “Aftësisë për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave”, “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes”, “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit”, “Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit” dhe “Cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik”, gjyqtari për secilin nga këto tregues është vlerësuar në nivelin maksimal dhe në total për të gjithë treguesin, me 100 pikë, në nivelin e vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Për “Aftësitë organizative”, që përbëhet nga këta nëntregues, tek grupkriteri “Aftësia e gjyqtarit për të përballuar ngarkesën në punë”, treguesi i parë “Respektimi i afateve ligjore”, mbasi janë interpretuar të dhënat nga burimet e vlerësimit, është konkluduar që gjyqtari duhet të vlerësohet për këtë tregues në nivelin “shumë i lartë”, duke u pikëzuar me 15 pikë.

Për “Plotësimin e standardeve minimale kohore”, e njëjta gjë, vlerësohet në nivelin “shumë i lartë”, duke u pikëzuar me 5 pikë.

“Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje”, maksimalisht vlerësohet “shumë i lartë”, me 5 pikë.

“Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore”, sipas burimeve të vlerësimit dhe siç e kemi cituar gjithmonë, merren të mirëqena të dhënat që na vijnë nga burimet e vlerësimit nga dosjet e rivlerësimit. Gjyqtari rezulton me rendiment 94.5%, që sipas Metodologjisë së miratuar, i korrespondon pikëzimi 8 pikë, niveli “mbi mesatar”. Për këtë tregues gjyqtari ka bërë kundërshtime, për të cilat do ndalem në fund.

Për treguesin “Koha mesatare të arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor”, gjyqtari, nga të dhënat që dalin nga burimet e vlerësimit, i ka të gjitha të arsyetuara dhe dorëzuara brenda këtyre afateve dhe për këtë arsye ai është vlerësuar në nivelin “shumë i lartë”, duke u pikëzuar me 15 pikë.

Për “Aftësinë për kryer procedurat gjyqësore”, nisur nga të dhënat që dalin nga burimet e vlerësimit dhe Metodologjia, rezulton që gjyqtari vlerësohet në nivelin “shumë i lartë”, duke u pikëzuar me 15 pikë.

Numri mesatar i seancave është 1.4, brenda 3-shit ai vlerësohet maksimalisht.

“Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor”, përsëri nisur nga të dhënat që dalin nga burimet e vlerësimit, nga ana ime si relatore propozoj që të vlerësohet në nivelin “shumë i lartë”, duke u pikëzuar me 20 pikë.

Grup treguesi i tretë “Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore”, që përbëhet nga “Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes”, është propozuar të vlerësohet “shumë i lartë” me 5 pikë.

“Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes”, propozohet të vlerësohet në nivelin “shumë i lartë”, duke u pikëzuar me 10 pikë.

Për të gjithë “Aftësive organizative”, me nivelin "Shkëlqyeshëm", me pikët totale 98.

Për grupkriterin “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, është propozuar që gjyqtari të vlerësohet maksimalisht me pikët maksimale për secilin nga nëntreguesit.

Për grupkriterin e fundit “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”, nga të dhënat që dalin nga burimet, gjyqtari propozohet të vlerësohet maksimalisht për “Komunikimin e qartë dhe transparent me kolegët”, duke u vlerësuar me “shumë i lartë”, me 25 pikë.

Më falni është për treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent...”, - ishte një lapsus fjalia më përpara. Pra vlerësohet në nivelin “shumë i lartë” me 25 pikë.

Treguesi “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale”, vlerësohet “shumë i lartë”, me 15 pikë.

“Aftësia për të bashkëpunuar me kolegët”, niveli i vlerësimit është propozuar “shumë i lartë”, me 15 pikë.

Shkalla e komunikimit me administratën dhe bashkëpunimi me to, propozohet të vlerësohet “shumë i lartë”, me 10 pikë.

“Gatishmëria për t’u angazhuar në veprimtari të tjera” dhe “Pjesëmarrja e gjyqtarit në formimin vazhdues...”, sipas të dhënave që dalin nga burimet dhe interpretimit që i është bërë legjislacionit në fuqi në kohën që i përket periudha e vlerësimit, propozohet që gjyqtari edhe për këtë tregues të vlerësohet maksimalisht me 20 pikë.

Për treguesin “Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr magjistratët e ardhshëm gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e magjistratëve”, nuk ka të dhëna dhe sipas Metodologjisë është propozuar të vlerësohet me 3 pikë.

Po kështu edhe për treguesin “Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstytucionale” është propozuar të vlerësohet me 3 pikë, pasi nuk ka të dhëna. Për këtë gjyqtari ka bërë kundërshtime, që do ndalem në fund.

“Publikimet ligjore akademike” nuk ka të dhëna dhe për këtë arsye pikëzohet me 0 pikë.

Në total, ajo që ka ardhur si propozim nga ana ime si relator, për “Aftësitë personale...” është niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", me pikët 91.

Në lidhje me kundërshtimet që ka bërë gjyqtari, e konkretisht për treguesin “Rendimenti i përfundimit të çështjeve” në grupkriterin e “Aftësive organizative”, siç edhe ju jenin njohur që në momentin kur janë bërë këto kundërshtime, nuk po ndalem t’i lexoj. Gjyqtari ka bërë arsyetimin që me pak fjalë e përmbledhim në faktin që nisur nga praktika që është pasur në këtë periudhë vlerësimi, ku gjyqtarët e gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm, gjykonin çështje civile sipas një formule që atyre iu ndaheshin çështjet dhe iu caktoheshin datat nga kryetari i gjykatës, ka rezultuar se gjyqtari i ka gjykuar të gjitha çështjet që i janë caktuar dhe ka marrë edhe një vërtetim që i është bashkangjitur kundërshtimeve të tij. Nga të dhënat që dalin nga ky vërtetim, rezulton se rendimenti është “mbi 99%”. Për këtë arsye, nisur nga ky kundërshtim dhe nga këto akte të paraqitura, unë si relatore propozoj që rendimenti duhet të vlerësohet maksimalisht me 10 pikë, duke rritur pra një nivel nga ajo që vjen si propozim në projektraport.

Për sa i përket treguesit të parafundit, tek “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”, gjyqtari ka bërë kundërshtime. Në kundërshtim ka bërë një parashtrim të disa fakteve dhe e lë në vlerësimin e Këshillit për ta marrë ose jo në konsideratë, nëse mund të quhet një aktivizim i tij në këto lloj aktivitete, ndër ato aktivitete që cilësohen si kontribut në marrëdhëniet ndërinstitucionale. Konkretisht gjyqtari ka thënë se ka marrë pjesë dhe ka qenë drejtuesi i njërit nga organizimeve të gjyqtarëve, konkretisht Unionit të Gjyqtarëve të Shqipërisë, ka qenë kryetar dhe më tutje ka vijuar edhe si anëtar bordi. Në kuadër të këtij angazhimi janë realizuar një sërë aktivitete që citoen sipas përmbajtjes dhe ku përfundon me “Këshilli e vlerëson që t’i shtohen edhe 2 pikët që parashikon Metodologjia e miratuar nga Këshilli”.

Sot, para se të fillonte mbledhja, është paraqitur dorazi nga gjyqtari një vërtetim i marrë nga Zyra e Regjistrimit të OJF-ve, ku pasqyrohet fakti që gjyqtari ka qenë kryetari i Unionit të Gjyqtarëve të Shqipërisë, i regjistruar në 2008-ën dhe ka qenë kryetar deri në vitin 2011.

Ndërkohë, mbas këtij momenti, në vitin 2014...

Do më falni sepse edhe për mua sapo ka ardhur vërtetimi dhe nuk e kam shumë të qartë përmbajtjen. Nëse është e nevojshme, mund të lexoj një pjesë të tij, për t’u bërë e njohur kjo përmbajtje edhe për anëtarët.

“Me vendimin e datës 04.02.2008 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë, si Organizatë Jofitimprurëse (Shoqatë), duke listuar anëtarësinë. Në 2008-ën është depozituar një vendim që është shtuar anëtarësia. Kryetar i Shoqatës u zgjodh zoti {...} dhe anëtar të bordit drejtues. Ndërsa me vendimin e datës 09.07.2011 është miratuar zgjedhja e anëtarëve të bordit drejtues dhe kryetarit të bordit, ku tashmë zgjidhet kryetar zoti {...} dhe zoti {...} vijon të jetë anëtar i bordit. Po kështu edhe me ndryshime në vitin 2014, që është edhe brenda periudhës së vlerësimit.” – këto janë fakte që dalin nga vërtetimi.

Në lidhje me pretendimet e gjyqtarit, nuk janë të shoqëruara me ndonjë dokumentacion. Në lidhje me këtë pretendim, unë si relatore, nuk kam propozim për të ndryshuar vlerësimin në lidhje me atë çfarë është propozuar tek projektraporti.

Nëse kolegët kanë pyetje ose propozime, unë me relatimin e projektraportit mendoj që mbarova. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zonja Kadi!

Atëherë, të fokusohemi vetëm aty ku ka propozime për ndryshimin e vlerësimit. Pra propozimi i parë i pranuar edhe nga relatorja ka të bëjë me çështjen e rendimentit, ku relatorja fillimisht e ka vlerësuar me 8 pikë, por në situatën që nga ana e magjistratit janë parashtruar pretendime dhe dokument shtesë, atëherë relatorja i propozon Këshillit që nga vlerësimi me 8 pikë, t'i bëhet një vlerësim në 10 pikë.

Jemi dakord me këtë?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Propozimi i dytë i kandidatit është për ndryshimin e vlerësimit tek indikatorit...

(Kërkon fjalën zonja Shehu.)

Marçela Shehu: Kryetare, kam unë diçka në lidhje me këtë moment.

Naureda Llagami: Thashë ta përfundojmë këtë që parashtroni Bruna dhe më pas, apo tek kjo çështje e ke?

Marçela Shehu: Për këtë çështje e kisha.

Duke qenë se Bruna nuk ka propozim, kisha unë diçka.

Naureda Llagami: Po, Marçela!

Marçela Shehu: Atëherë, lidhur me treguesin “Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata”, unë vlerësoj se gjyqtari duhet të vlerësohet me 5 pikë, pasi çmuj se angazhimi i tij si anëtar i bordit drejtues së Unionit të Gjyqtarëve për periudhën 2014-2015 duhet të konsiderohet si veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë. Theksoj se zoti Kalaja fillimisht ka qenë kryetar i parë i Unionit të Gjyqtarëve, pra angazhimi i tij në këto lloj veprimtarish ndërinstitucionale origjinën e kanë që në vitin 2008, por duke qenë se ne vlerësojmë vetëm periudhën 2013-2016, në vlerësimin tim edhe qenia e tij si anëtar i bordit drejtues të Unionit dhe angazhimi i tij në veprimtaritë e këtij Unioni për këtë periudhë, duhet të konsiderohet si pjesëmarrje e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale. Në këto kushte, nga vlerësimi 3 pikë që propozohet nga relatorja, unë vlerësoj dhe propozoj që ky vlerësim të jetë 5 pikë. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, Marçela!

Atëherë, kalojmë propozimin e Marçelës, meqë s’kemi propozime të tjera. “Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata”, nga 3 pikë vlerësuar nga relatorja, të kalojë në 5, pra t’i shtohen 2 pikë. Jeni dakord?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Kundër.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Kundër.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Kundër, me arsyetimin se angazhimet në kuadrin e veprimtarinë ndërinstitucionale kërkojnë që të vlerësohen me 2 pikët shtesë (sepse 3 pikë

i marrin të gjithë gjyqtarët) kërkojnë një kontribut real të gjyqtarit në këto veprimtari. Në kushtet kur nuk kemi prova që dokumentojnë këtë kontribut. Thjesht fakti i pjesëmarrjes në bord, në vlerësimin tim nuk është i mjaftueshëm që të kemi rritje të pikëzimit nga 3 në 5 pikë. Për këtë arsye mendoj që të votoj kundër.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Pro.

Atëherë, për treguesin pjesëmarrja e gjyqtarit në këto veprimtari ndërinstitucionale, miratohet propozimi i bërë nga zonja Shehu dhe kalon në vlerësimin 5 pikë.

Në total për magistratin kemi nivelin "Shkëlqyeshëm" dhe gjithsej 393 pikë. Jemi dakord?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord, përveç pjesës që votova kundër.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Miratimin e "Raporti i vlerësimit etik dhe profesional me qëllim gradimi, të gjyqtarit {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016", duke e vlerësuar atë si më poshtë:

- A. Aftësitë profesionale – "Shkëlqyeshëm";
 - B. Aftësitë organizative – "Shkëlqyeshëm";
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – "Shkëlqyeshëm";
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – "Shkëlqyeshëm".
- Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – "Shkëlqyeshëm".

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2021

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.06.2021)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional, të gjyqtarit {...}, për vitin 2019”, relator z. Erjon Muharremaj.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:05 dhe mbaroi në orën 13:50.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Medi Bici | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 7. Ilir Toska | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 10. Marçela Shehu | (anëtare) |

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Aleksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 6. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
- 7. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional, të gjyqtarit {...}, për vitin 2019”, relator z. Erjon Muharremaj.

Naureda Llagami: Kalojmë tek çështja e radhës që ka të bëjë edhe kjo me vlerësimin etik dhe profesional, për vitin 2019, të gjyqtarit Artir Kalaja.

Për më shumë detaje, fjalën ia jap zotit Muharremaj.

Erjon Muharremaj: Faleminderit, zonja Kryetare!

Në lidhje me vlerësimin për vitin 2019 për gjyqtarin {...} jeni njohur me projektraportin e vlerësimit dhe me të gjithë dokumentacionin tjetër që lidhet me të, përfshirë edhe disa parashtrës të paraqitura nga gjyqtari për projektraportin që i është dërguar atij.

Unë do të ndalem në mënyrë të veçantë pikërisht në këto pika ku gjyqtari ka pasur pretendime në lidhje me projektraportin që i është dërguar dhe pa humbur kohë do të filloj duke referuar treguesit e veçantë dhe propozimin që kam bërë në cilësinë e relatorit për përcaktimin e shkallës së aftësisë dhe pikëzimin respektiv.

Sa i përket “Aftësisë për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave”, propozoj që shkalla e aftësisë të konsiderohet “shumë e lartë” dhe pikëzimi 25 pikë.

Në lidhje me “Aftësinë për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes”, propozimi është që shkalla e aftësisë është “shumë e lartë” dhe pikëzimi 25 pikë.

Sa i përket “Qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit”, propozoj që shkalla e aftësisë të konsiderohet si “shumë e lartë” dhe pikëzimi 15 pikë.

Në lidhje me “Strukturën e qëndrueshme dhe të mirëorganizuar e vendimit”, propozoj që shkalla e aftësisë të konsiderohet “shumë e lartë” dhe pikëzimi 10 pikë.

Sa i përket “Cilësisë së analizës dhe argumentimit logjik”, propozimi është që shkalla e aftësisë të konsiderohet “shumë e lartë” dhe pikëzimi 25 pikë.

Në total, për të gjithë kriterin e “Aftësive profesionale të gjyqtarit” propozimi është që të pikëzohet me 100 pikë dhe niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm"

Sa i përket “Aftësive organizative të gjyqtarit”, në lidhje me “Respektimin e afateve ligjore”, shkalla e aftësisë në këtë rast niveli i treguesit është në kategorinë “21-30%” dhe propozimi është që të vlerësohet me 9 pikë.

Sa i përket “Plotësimin të standardeve minimale kohore”, propozimi është që të vlerësohet sa i përket kategorisë “nga 0-10%”, duke u pikëzuar me 5 pikë.

Në lidhje me “Kohën mesatare që i dedikohet çdo çështjeje”, vlerësohet që ajo është më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve dhe propozimi është që të pikëzohet me 5 pikë.

Në lidhje me “Rendimentin e përfundimit të çështjeve gjyqësore”, propozimi fillestar është që shkalla e aftësisë të vlerësohet se është në kategorinë “nga 87-93%” dhe propozimi ka qenë për 6 pika.

Në parashtrimet e veta, gjyqtari ka parashtruar se numri i çështjeve të shortuara dhe të pagjykuara nuk ka lidhje me pakësimin e gjykimeve nga ana e tij, por me uljen e numrit të gjyqtarëve tek të cilët shorthohen çështjet. Nga ana tjetër, fakti i mësipërm ka ndikuar edhe në shtyrjen e gjykimeve për plotësimin e trupave gjykues dhe në raste të caktuara edhe për rinisjen nga fillimi të shqyrtimit. Më tej, duke qenë që ju jeni njohur me kundërshtimet, unë nuk po i citoj të gjitha referimet që ka bërë gjyqtari tek

Metodologjia e Pikëzimit, por ai thotë që Metodologjia lidhur me këtë tregues, përcakton që hapësira e vlerësuesit për të përcaktuar një shkallë më të lartë pikëzimi, bazuar në analizën e të gjithë burimeve të vlerësimit, nisur nga tregues të tillë si: kompleksiteti i çështjeve, ngarkesa e gjyqtarit, rritja e volumit të punës, aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës; mund të çojnë deri në një pikëzim maksimal nëse gjyqtari ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50% të standardit minimal të ngarkesës së përcaktuar nga Këshilli.

Lidhur me këtë tregues, gjyqtari referon se: “Në nenin 2, shkronja “I” të Ligjit për Statusin, përcaktohet se: "Rendimenti i përfundimit të çështjeve" për një magjistrat është raporti i numrit të çështjeve gjyqësore të përfunduara prej tij me numrin e çështjeve gjyqësore të caktuara brenda një viti kalendarik”, dhe sipas gjyqtarit termi “çështje gjyqësore të caktuara brenda një viti kalendarik” nënkupton çështjet e regjistruara rishtazi në gjykatë, të cilat, përmes shortit, i caktohen gjyqtarit për gjykim (në cilësinë e relatorit). Në logjikën e ligjit, çështjet e regjistruara, pas shortimit, i kalojnë menjëherë për veprim gjyqtarit, i cili planifikon gjykimin e tyre pa vonesë.

Në fakt, nisur dhe nga rregullat procedurale të gjykimit, një gjë e tillë ndodh vetëm për çështjet e regjistruara në gjykatat e shkallës së parë, pasi për gjykatat e apelit nuk mund të thuhet e njëjta gjë, si përpara miratimit të Ligjit nr.96/2016, e veçanërisht për situatën aktuale, përfshirë edhe për periudhën objekt vlerësimi, vitin 2019.

Në dijeninë time, gjykatat e apelit në përgjithësi e në veçanti Gjykata e Apelit Tiranë, përfshirë edhe periudhën objekt vlerësimi, objektivisht kanë qenë në pamundësi të gjykonin çështjet e regjistruara gjatë vitit përkatës kalendarik.

Prej vitesh koha e fillimit të gjykimit në Gjykatën e Apelit Tiranë, në rastin më të mirë, ka qenë tej një viti nga regjistrimi i saj dhe aktualisht mbi tre vjet.”

Referuar në sa më sipër, në vlerësimin e gjyqtarit do të ishte objektivisht më e drejtë që në llogaritjen e rendimentit të përfundimit të çështjeve nga ana gjyqtarëve të gjykatës së apelit ku bën pjesë, sa i përket periudhës objekt vlerësimi, në kuptim të “numrit të çështjeve të caktuara gjatë vitit kalendarik”, të konsiderohej “numri i çështjeve të shpallura për gjykim”. Këtu pastaj i referohet edhe Metodologjisë së Vlerësimit, që nuk po e citoj, dhe për këtë gjyqtari ka në konsideratë të dhënat statistikore në këtë

drejtim, konkretisht si me poshtë: Në vitin 2019, janë shpallur për gjykim 234 çështje dhe gjyqtari ka përfunduar gjykimin e 248 çështjeve. Gjyqtari sqaron që këto të dhëna i përkasin veprimtarisë së tij vetëm pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, sepse ai ka qenë gjithashtu i përfshirë edhe në çështje për të cilat është deleguar nga KLGJ-ja në gjykata të tjera apeli.

Referuar vendimeve përkatëse, gjyqtari thotë që gjatë vitit 2019 është deleguar në 7 çështje në Gjykatën e Apelit Korçë, 1 çështje në Gjykatën e Apelit Durrës, 1 çështje në Gjykatën e Larë dhe 1 çështje në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda, çështje e cila ende nuk ka përfunduar, -saktëson gjyqtari. Në mbështetje të kundërshtimeve gjyqtari ka paraqitur vërtetimin me nr. {...} prot., datë 26.05.2021 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Referuar sa më sipër, duke parë edhe statistikat/të dhënat statistikore të dorëzuara nga gjyqtari, ku rezulton se për periudhën e vlerësimit gjyqtari ka shpallur 234 çështje (civile dhe penale) dhe ka gjykuar 248, si dhe duke pasur parasysh ngarkesën tejet të lartë të Gjykatës së Apelit Tiranë, ndikuar kjo edhe nga procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve, duke sjellë largimin nga detyra të disa prej gjyqtarëve të kësaj gjykate, fakt që ndikoi në mjaft raste në shtyrjen e seancave gjyqësore dhe në disa raste në fillimin nga e para të shqyrtimit të çështjeve, në cilësinë e relatorit propozoj që aftësia e gjyqtarit për këtë tregues duhet të vlerësohet një nivel më lart se ai i propozuar fillimisht prej meje, pra të konsiderohet sa i përket kategorisë “mbi 93-99%” dhe nga 6 pikë që ishte propozimi fillestar, të pikëzohet 8 pikë (pra jo në nivelin maksimal prek 10 pikësh).

Në lidhje me “Kohën mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor”, propozohet që kjo të vlerësohet si më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve dhe të pikëzohet me 15 pikë.

Në lidhje me “Numri mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive”, propozohet që shkalla e aftësisë të konsiderohet 1-3 seanca dhe ose shkallë shumë e lartë e aftësisë dhe të pikëzohet me 15 pikë.

Në lidhje me “Kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor”, shkalla e aftësisë konsiderohet si “shumë e lartë”, propozimi për 20 pikë.

Në lidhje me “Rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes”, shkalla e aftësisë konsiderohet si “shumë e lartë”, pikëzimi me 5 pikë.

Në lidhje me “Saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes”, shkalla e aftësisë konsiderohet si “shumë e lartë”, pikëzimi me 10 pikë.

Në total, për kriterin e “Aftësive organizative të gjyqtarit”, nga propozimi fillestar që ishte 90 pikë, propozoj që të shtohen edhe 2 pikët referuar treguesit të “Rendimentit të përfundimit të çështjeve gjyqësore”, duke shkuar në total në 92 pikë, dhe niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Në lidhje me “Etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale”, sa i përket treguesit të “Angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion”, shkalla e aftësisë konsiderohet si “shumë e lartë”, pikëzimi 35 pikë.

Në lidhje me “Shmangien e shfaqjes së pahijshme, nderit dhe dinjitetit”, shkalla e aftësisë konsiderohet si “shumë e lartë”, pikëzimi 40 pikë.

“Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese”, shkalla e aftësisë konsiderohet si “shumë e lartë”, pikëzimi 10 pikë.

“Numri tejet i lartë i kërkesave të pranura të palëve për përjashtimin e gjyqtarit”, ky numër është i pakonsiderueshëm dhe propozohet pikëzimi me 15 pikë.

Në total, për të gjithë kriterin e “Etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale”, propozohet vlerësimi prej 100 pikësh dhe niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Sa i përket kriterit të “Aftësive personale dhe angazhimit profesional”, në lidhje me treguesin e “Komunikimit të qartë dhe transparent”, shkalla e aftësisë konsiderohet si “shumë e lartë”, pikëzimi 25 pikë.

Në lidhje me “Respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale”, shkalla e aftësisë konsiderohet “e lartë”, pikëzimi 15 pikë.

Në lidhje me “Shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta”, shkalla e aftësisë konsiderohet si “shumë e lartë”, pikëzimi 15 pikë.

Në lidhje me “Shkallën e komunikimit me administratën gjyqësore”, shkalla e aftësisë konsiderohet si “shumë e lartë”, pikëzimi me 10 pikë.

Në lidhje me “Pjesëmarrjen e gjyqtarit në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale”, konsiderohet se i përket periudhës “nga 5-40 ditë” dhe për këtë vlerësimi është propozuar 20 pikë.

Në lidhje me “Disponueshmërinë e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve”, rezulton që gjyqtari ka qenë i angazhuar në një aktivitet në cilësinë e ekspertit, aktivitet i zhvilluar në datat 11 dhe 12 shkurt të vitit 2019, prandaj, përderisa ka të dhëna, propozohet që të pikëzohet me 5 pikë.

Në lidhje me “Pjesëmarrjen e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata”, propozimi im, duke qenë që nuk ka të dhëna gjatë kësaj periudhe për angazhimin e gjyqtarit, është që të vlerësohet me 3 pikë.

Në parastresën e tij, gjyqtari është shprehur që ka marrë pjesë në disa takime dhe ka dhënë mendim sa herë që i është kërkuar, por duke e konsideruar këtë si detyrë, shprehet që nuk ka vlerësuar që ftesat dhe komunikimet t’i ruajë, me qëllim vërtetimin e tyre në këtë proces.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit do konsiderojmë veprimtari jashtë funksionit: fjalimet publike, prezantimet në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, pjesëmarrjen në programet e edukimit të komunitetit, bashkëpunimi me Këshillin për përmirësimin e programeve të formimit vazhdues, angazhimi si ekspert në punët e Këshillit, kontribute në hartimin e legjislacionit, aktivitetin mësimdhënës, bashkëpunime me grupe të ndryshme interesi; me qëllim rritjen e cilësisë së gjyqësorit dhe ndërgjegjësimin e publikut për forcën e zbatimit të ligjit, si edhe çdo veprimtari tjetër e ngjashme në fushën juridike.

Edhe duke marrë parasysh faktin që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, por në mungesë të një dokumentacioni provues, sa i përket angazhimit të gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale, i qëndroj propozimit fillestar që gjyqtari të pikëzohet me 3 pikë.

Sa i përket treguesit të “Publikimeve ligjore akademike”, duke qenë që nuk ka të dhëna dhe për publikime të gjyqtarit gjatë kësaj periudhe, propozimi është që të pikëzohet me 0 pikë.

Për kriterin e katërt të “Aftësive personale dhe të angazhimit profesional”, propozimi është që të jetë me 93 pikë dhe niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Në total, për të katër kriteret, propozimi përfundimtar është që nga 383 pikë që ishte propozimi fillestar, të shtohen edhe 2 pikët që siç u referua në analizën që iu bë “Aftësive organizative të gjyqtarit”, 383 pikë + 2 pikë, të shkojë 385 pikë dhe niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Ju faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Muharremaj!

Atëherë, ndalojmë vetëm tek propozimet që ka pranuar fillimisht relatori, që bëhet fjalë për indikatorin që ka lidhje me rendimentin, ku nga 6 pikë, për shkak të të dhënave të parashtruara nga magjistrati, shkon në 8 pikë. Jeni dakord?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Ka ndonjë diskutim nga kolegët?

Brikena Ukperaj: Po, zonja Kryetare, kam edhe unë një propozim.

Naureda Llagami: Po, Brikena!

Brikena Ukperaj: Atëherë, kam një propozim lidhur me treguesin “Respektimi i afateve ligjore” tek kriteri i “Aftësisë organizative”. Referuar raportit analitik dhe projektraportit të vlerësimit është bërë analizë matematikore dhe deri diku logjike e të dhënave statistikore, lidhur me pikëzimin dhe shkallën e aftësisë të propozuar nga relatori. Në vlerësimin tim duhet që shkalla e aftësisë së gjyqtarit të vlerësohet në një nivel më të lartë se ajo që i përket pikëzimit prej 9 pikësh, duke u pikëzuar gjyqtari me 12 pikë, për këto arsye që do të them në vijim:

Gjyqtari, ndryshe nga të gjithë gjyqtarët që kemi pasur deri tani, ka pasur një numër të konsiderueshëm të çështjeve me afat ligjor, rreth gjysmën e çështjeve të përfunduara gjatë vitit 2019 (40 e ca për qind), janë 102 apo 103 çështje me afat ligjor. Nga ana tjetër, gjyqtarët e apelit gjykojnë sipas kalendarit të gjyqimit dhe janë vetë ata që i nxjerrin çështjet për gjykim duke iu dhënë prioritet sigurisht çështjeve me afat ligjor, por duke mos neglizhuar edhe çështjet e tjera që parashikojnë standard minimal, sipas moshës apo vjetërsisë së çështjeve të paraqitura në gjykatë.

Në rastin konkret, duke marrë parasysh volumin shumë të madh të çështjeve me afat ligjor që ka pasur zoti {...} si gjyqtar relator, duke marrë parasysh ngarkesën e punës, volumin e punës që i është dashur të përballojë për shkak të caktimit në gjykata të tjera nga ajo ku ushtron funksionin, vlerësimit të kryetarit dhe vetëvlerësimit të gjyqtarit, vlerësoj që në rastin konkret, analiza matematikore të mos ngelet tek shkalla e aftësisë që i përket 9 pikëshit, pra 30% të çështjeve me afat ligjor, por të kalojmë në një nivel më të lartë vlerësimi, sipas analizës logjike, sepse vlerësoj që ka shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit që nuk ka mundur që të jetë maksimalisht efektiv në respektimin e afateve ligjore. Sigurisht që nuk jam për vlerësim maksimal, referuar faktit që gjyqtari duhet, pavarësisht respektimit të kalendarit të gjyqimit, t’i kushtojë rëndësi më të madhe çështjeve me afat ligjor, por vlerësoj që në këtë rast, volumi i çështjeve me afat ligjor ka qenë përcaktues në punën e gjyqtarit, prandaj mendoj që shkalla e aftësisë së tij (pavarësisht se gjyqtari vetë nuk e ka kundërshtuar në fakt por unë këtë qëndrim kam mbajtur edhe në vlerësimet e tjera) duhet të pikëzohet jo me 9 pikë por me 12 pikë. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, Brikena!

Atëherë, kalojmë në votim propozimin që sapo bëri Brikena lidhur me “Respektimin e afateve ligjore”, nga vlerësimi i bërë nga relatori 9 pikë, Brikena propozon që t’i shtohen 3 pikë, pra të shkojë vlerësimi në 12 pikë. Jemi dakord?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, në total, pas miratimit të propozimeve, nga 383 që ishte pikëzimi për të katër kriteret, në total jemi në 388 pikë, ndërkohë që niveli përfundimtar i vlerësimit mbetet i njëjtë "Shkëlqyeshëm". Jeni dakord?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për vitin 2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

- A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.
- Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2021

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.06.2021)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të katër kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 123, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:05 dhe mbaroi në orën 13:50.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| <i>1. Naureda Llagami</i> | <i>(kryetare)</i> |
| <i>2. Maksim Qoku</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>3. Medi Bici</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>4. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |

- | | |
|-----------------------------|------------------|
| <i>6. Brunilda Kadi</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>7. Ilir Toska</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>9. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>10. Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>11. Erjon Muharremaj</i> | <i>(anëtar)</i> |

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Aleksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 6. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
- 7. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të katër kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 123, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen e radhës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të katër kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për

Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar...”, për më shumë detaje fjalën ia jap zonjës Shehu.

Marçela Shehu: Faleminderit, Kryetare!

Me vendimin nr. 123, datë 01.04.2021 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë. Brenda afatit të kandidimit, për pozicionin e lirë të shpallur me këtë vendim, ka kandiduar gjyqtarja zonja {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, aktualisht e komanduar si këshilltare ligjore pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 179, datë 29.04.2021 ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e shpallura me vendimet nr. 123, 125, 127, 128, datë 01.04.2021 dhe pas procedurës së shortit jam caktuar me cilësinë e relatores lidhur me verifikimin e plotësimit nga kandidatja {...} të kriterëve që kërkon ligji, pikërisht për kandidimin në këtë pozicion në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Gjatë procedurës së verifikimit ka rezultuar, ashtu siç edhe ju e keni të referuar në mënyrë të detajuar në relacion, ka rezultuar se zonja {...} plotëson të gjitha kriteret që kërkon ligji lidhur me kriteret formale që kërkon ligji lidhur me kandidimin e saj në këtë pozicion. Kështu zonja {...} rezulton se plotëson kriterin e përvojës profesionale minimale, rezulton të ketë mbi 7 vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtare në gjykatën e shkallës së parë, duke llogaritur këtu edhe periudhën si e komanduar, gjithashtu ajo plotëson edhe kriterin që kërkon ligji për përvojën profesionale specifike në fushën e së drejtës penale, pasi rezulton që edhe pas kohës së kryerjes së stazhit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë edhe gjatë kohës së punës së saj si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat, ajo ka gjykuar çështje penale për periudhën që kërkon ligji, pra për periudhën mbi 5 vjet.

Gjithashtu, për kandidaten është verifikuar kriteri i dhënies së pëlqimit për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake sipas ligjit 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”. Kandidatja, në respektim të përcaktimeve ligjore ka dhënë pëlqimin e shprehur sipas formularëve përkatës për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake sipas ligjit 95/2016.

Për kandidaten është verifikuar gjithashtu edhe kriteri i mospasjes masë disiplinore në fuqi. Në lidhje me këtë kriter kandidatja ka depozituar formularin e vetëdeklarimit për masat disiplinore, ku ajo parashtron se nuk ka masa disiplinore në fuqi, fakt që vërtetohet i provuar edhe nga informacioni i marrë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit.

Rezulton gjithashtu që kandidatja plotëson edhe kriterin e papajtueshmërisë ambientale. Në lidhje me këtë kriter, në rastin e aplikimit, në përputhje me detyrimin sipas nenit 8, pika 5, të Ligjit për Statusin, kandidatja ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për situatën e papajtueshmërisë ambientale” datë 16.04.2021, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: “Nuk do të ndodhem në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016. . Gjatë verifikimit nuk rezultoi ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidatja në lidhje me situatën e papajtueshmërisë ambientale për sa ajo kandidon për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Bazuar në sa më sipër, pasi projektvendimi dhe relacioni përkatës, lidhur me pjesën e procedurës kanë kaluar për miratim edhe nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, ku ky Komision ka vlerësuar se procedura e verifikimit lidhur me kriteret formale është e plotë, me cilësinë e relatores, i propozoj Këshillit të Lartë Gjyqësor të shqyrtojë projektvendimin përkatës dhe të vendosë verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 123, datë 01.04.2021, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “dhënies së pëlqimit për kontrollin periodik të

llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, kritere të cilat lidhen me verifikimin e pasurisë dhe të figurës. Ky është propozimi drejtuar Këshillit lidhur me këtë kandidatë.

Naureda Llagami: Faleminderit, zonja Shehu!

Atëherë, nëse nuk kemi diskutime, kalojmë në votim të propozimit të ardhur.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të katër kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 123, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2021

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.06.2021)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të katër kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 128, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:05 dhe mbaroi në orën 13:50.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| <i>1. Naureda Llagami</i> | <i>(kryetare)</i> |
| <i>2. Maksim Qoku</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>3. Medi Bici</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>4. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |

- | | |
|-----------------------------|------------------|
| 6. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 7. Ilir Toska | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 10. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 11. Erjon Muharremaj | (anëtar) |

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Aleksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 5. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 6. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.**
- 7. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.**

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të katër kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 128, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin e radhës, që edhe kjo ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të katër kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë”. Për më shumë detaje ia jap fjalën sërish zonjës Shehu.

Marçela Shehu: Me vendimin nr. 128, datë 01.04.2021, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për një pozicion të lirë në këtë gjykatë. Brenda afatit të kandidimit për këtë pozicion ka kandiduar gjyqtarja zonja {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, e cila më herët ka kandiduar edhe për dy pozicione të tjera të lira në gjykatën e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, konkretisht për një pozicion në Gjykatën e Apelit Durrës dhe një pozicion në Gjykatën e Apelit Vlorë, kandidatë për të cilat verifikimi normal është realizuar nga Këshilli.

Me vendimin përkatës të Këshillit jam caktuar me cilësinë e relatores për të verifikuar plotësimin nga kandidatja znj. {...} të kriterëve ligjore të kandidimit lidhur me kandidimin e saj për një pozicion në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Pas procedurës së verifikimit, lidhur me kriteret formale, pasi lidhur me kriteret e figurës dhe pasurisë, ky verifikim vijon, por për t'i hapur rrugë procesit të vlerësimit, siç është bërë tashmë standard nga Këshilli që bëhet verifikimi i kriterëve ligjore formale për t'i hapur rrugë vlerësimit, për këto kriterë, gjatë procedurës së verifikimit ka rezultuar se kjo kandidatë i plotëson, pa u ndalur në mënyrë të detajuar, të gjithë këto kriterë. Kështu ajo plotëson kriterin e “përvojës profesionale minimale”. Rezulton të ketë mbi 7 vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtare, mbi 5 vjet përvojë profesionale specifike në fushën e së drejtës penale. Plotëson kriterin e “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, bazuar në deklarin e saj por edhe nga verifikimi që është bërë pranë departamentit përkatës në Këshill. Rezulton të plotësojë kriterin e “dhënies së pëlqimit për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016. Në lidhje me këtë kriter, kandidatja ka depozituar formularin përkatës që kërkohet në këtë rast. Gjithashtu rezulton që kandidatja plotëson edhe kriterin tjetër formal, kriterin e “papajtueshmërisë ambientale”. Në lidhje me këtë kriter ajo ka plotësuar formularin e vetëdeklarimit, ku ka deklaruar situatën e papajtueshmërisë ambientale dhe gjatë verifikimit nuk ka rezultuar ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidatja.

Në këto kushte, pas verifikimit edhe nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës lidhur me saktësinë e procedurës së verifikimit, me cilësinë e relatores, i propozoj Këshillit që të shqyrtojë projektvendimin përkatës dhe të vendosë verifikimin e plotësimit nga kjo kandidatë të kritereve ligjore që kërkon kandidimi i saj në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe vijimin e procedurës së mëtejshme lidhur me verifikimin e kritereve të tjera që lidhen me figurën dhe me pasurinë. Faleminderit, Kryetare!

Naureda Llagami: Faleminderit, Marçela!

Atëherë, nëse nuk kemi ndonjë diskutim lidhur me projekt-aktin e propozuar, kalojmë në votimin e tij?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të katër kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 128, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2021

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.06.2021)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për skualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe përjashtimin e saj nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:05 dhe mbaroi në orën 13:50.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli** (anëtare)
- 5. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 6. Brunilda Kadi** (anëtare)
- 7. Ilir Toska** (anëtar)
- 8. Alban Toro** (anëtar)
- 9. Brikena Ukperaj** (anëtare)

10. Marçela Shehu (anëtare)

11. Erjon Muharremaj (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Aleksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 6. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
- 7. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për skualifikimin e kandidates znj. {...} dhe përjashtimin e saj nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).

Naureda Llagami: Kalojmë sipas rendit të ditës tek çështja e pestë që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për skualifikimin e kandidates znj. {...} dhe përjashtimin e saj nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë”, përgatitur edhe ky projekt-akt nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Do të relatohet nga zonja Shehu.

Marçela Shehu: Faleminderit, Kryetare!

Me Vendimin nr. 87, datë 26.02.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: “1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.” Branda afateve të kandidimit për këtë pozicion ka kandiduar edhe gjyqtarja znj. {...}, aktualisht gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Me vendimin përkatës të Këshillit dhe pas procedurave të shortit, unë jam caktuar me cilësinë e relatores lidhur me verifikimin e plotësimit nga kjo kandidatë të kritereve ligjore që kërkon ligji lidhur me kandidimin e saj për një pozicion në Gjykatën e Lartë.

Pas procedurës së realizuar dhe pas propozimit përkatës në Këshill, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 330, datë 17.09.2020 ka vendosur:

“1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 87, datë 26.02.2020, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit... .”

Më pas, Këshilli, me vendimin nr. 337, datë 24.09.2020, ka vendosur: Fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional viti kalendarik 2019, për gjyqtarët që kanë plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë në Gjykatën e Lartë, ku është caktuar relatori, nëpunësi përgjegjës për zonjën {...}.

Nga ana tjetër, për kandidaten znj. {...} ka vijuar procedura e verifikimit për kriteret e kandidimit, pikërisht të pasurisë dhe të figurës, ndërsa Këshilli ka qenë në pritje të përfundimit me përparësi të procesit të rivlerësimit kalimtar për kandidaten. Gjatë kësaj procedure, me shkresën nr. {...} prot., datë 24.02.2021, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njoftoi Këshillin e Lartë Gjyqësor për përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar për kandidaten znj. {...}, si subjekt rivlerësimi “ex officio” sipas nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe se, me Vendimin nr. 350, datë 23.02.2021, ka vendosur: “Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. {...}, si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë”.

Mbas shqyrtimit të të dhënës së njoftuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, si dhe të dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit, në Mbledhjen e datës 18.03.2021, bazuar në pikën 12, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit nr.75/2019, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vendosi që kandidatja znj. {...} të njoftohej për gjetjen

e kësaj procedure në lidhje me një prej kritereve të kandidimit për emërim/ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, pikërisht atë të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

Më datë 18.03.2021, në rrugë elektronike, kandidates i është dërguar Njoftimi “Për gjetjen e procedurës së verifikimit”.

Në Njoftimin “Për gjetjen e procedurës së verifikimit”, kandidates i është bërë e ditur se gjatë procedurës së verifikimit ishte evidentuar një rrethanë, e cila, bazuar në pikën 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 i ndryshuar, mund të passillte skualifikimin/ndalimin e kandidimit të saj për emërimin/ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, e konkretisht ajo e “pasjes masë disiplinore në fuqi”.

Lidhur me rrethanën që mund të passillte skualifikimin/ndalimin e kandidimit të saj për emërimin/ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, në Njoftimin “Për gjetjen e procedurës së verifikimit”, kandidates i është bërë e ditur se “Shkarkimin nga detyra”, me Vendimin nr. 350, datë 23.02.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, përbënte masë disiplinore në kuptim të neneve 58, pika 1, shkronja “c”, 61 dhe 62, të Ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ndërkohë që, në pikën 8, të nenit 48, të Ligjit nr.96/2016, përcaktohej se: “Vetëm kandidatët të cilët kalojnë verifikimin e pasurisë dhe figurës dhe që nuk kanë masa disiplinore në fuqi, pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë”. Kurse në pikën 7, Seksioni B, Kreun X, të Vendimit nr.75/2019, nxjerrë, ndër të tjera, edhe për zbatimin e neneve 32 dhe 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohej se: “7. Kandidatët subjekt i procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, të cilët nuk janë konfirmuar në detyrë me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, edhe kur ndaj atij vendimi është paraqitur ankim, nuk pranohen të kandidojnë dhe nuk i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve të tjera ligjore të kandidimit sipas pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusin”.

Nëpërmjet Njoftimit “Për gjetjen e procedurës së verifikimit”, kandidates i është bërë e ditur se, në respektim të të drejtës për t’u dëgjuar të subjektit në një procedurë administrative, si dhe në zbatim të Vendimit nr.75/2019, kishte të drejtën për të paraqitur

shpjegime lidhur me gjetjen e procedurës së verifikimit, si dhe çdo dokumentacion mbështetës sipas vlerësimit të saj, ndërsa afati për paraqitjen e shpjegimeve ishte 5 (pesë) ditë dhe fillonte nga dita e nesërme e marrjes së njoftimit.

Bashkë me Njoftimin, kandidates i është dërguar edhe shkresa nr. {...} prot., datë 24.02.2021, e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Brenda afatit të caktuar, më datë 30.03.2021, kandidatja ka depozituar në Këshill shpjegime në lidhje me gjetjen e procedurës së verifikimit.

Në shpjegimet e saj për gjetjen e procedurës së verifikimit, kandidatja ka parashtruar se:

“Duke shpresuar në mbarëvajtjen e detyrës suaj, në vijim, po prezantoj argumentet faktikë dhe ligjorë ndaj vendimit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës nr.1288 prot, të datës 24.03.2021, i cili, shoqëruar me “Njoftimin për gjetjen e procedurës së verifikimit” më është njoftuar në mënyrë elektronike, nëpërmjet adresës së e-mail-it, më datë 25.03.2021. ...

Në funksion të realizimit të një procesi të rregullt ligjor, në respektim të të drejtës për t’u dëgjuar të subjektit në një procedurë administrative, si dhe në zbatim të shkronjës “a”, pika 12, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75... (ka cituar njoftimin i ka dërguar Komisioni i Zhvillimit të Karrierës).

Siç është paraqitur dhe në aktet e sipërtreguara, unë kam kandiduar, për emërimin/ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e tij nr. 87, datë 26.02.2020.

Në vijim, me vendimin nr. 330, datë 17.09.2020, Këshilli ka vendosur verifikimin e plotësimit nga ana ime të kriterëve të përvojës profesionale, mospasjes masë disiplinore në fuqi dhe të mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale, dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit tim, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë.

Për përshpejtimin e kësaj procedure, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit , nisi ndaj meje procesin e rivlerësimit kalimtar si subjekt rivlerësimi “ex officio”, sipas nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Ligjit nr. 84/2016 dhe me Vendimin nr.

350, datë 23.02.2021, ka vendosur: “Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. {...}, si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë”.

Në shkresën shoqëruese të vendimit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës nr. {...} prot, të datës 24.03.2021 është parashtruar se (dhe është parashtruar nga kandidatja përmbajtja e shkresës së dërguar nga ana e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës që u citua pak më sipër). Kandidatja parashtron se nuk pajtohet me atë çfarë ka referuar Komisioni për sa më poshtë:

Kandidatja vlerëson se pika 7 e vendimit nr. 75, datë 23.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe konkluzioni i prezantuar në shkresën e mësipërme sipas të cilës evidentohet një rrethanë, e cila, bazuar në pikën 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 mund të passjell skualifikimin/ndalimin e kandidimit tuaj për emërimin/ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, e konkretisht ajo e “pasjes masë disiplinore në fuqi”, nuk pajtohet me parashikimet ligjore të ligjit 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe gjithashtu nuk pajtohet me parimet kushtetuese dhe konventore të procesit të rregullt ligjor, të shtetit të së drejtës, sigurisë juridike, ankimit efektiv, parimit të barazisë dhe parimit të prezumimit të pafajësisë.

1. Papajtueshmëria me ligjin nr. 84/2016 dhe ligjin nr. 96/2016.

Siç është prezantuar dhe më sipër, KPK-ja me Vendimin {...}, datë 23.02.2021 ka vendosur: “Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. {...}, si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë”.

Ky vendim më është dorëzuar i arsyetuar në rrugë postare, më datë 26.03.2021, domethënë, një ditë më vonë nga aktet e dërguara nga ana juaj.

Pasi u njoha me arsyetimin e vendimit të sipërcituar, konstatova se ky i fundit është i pabazuar në ligj, dhe është nënvlerësuar marrja, çmuarja dhe analizimi i të gjithë provave shkresore të paraqitura nga ana ime, qe dëshmonin qartazi, bindshëm, në nivel të besueshëm dhe pa lënë vend fare për ekuivok, për ligjshmërinë e burimeve të krijimit të pasurisë së familjes sime.

Në nenin 63, pika 1 të ligjit 84/2016, parashikohet se “1. Të gjitha vendimet e Komisionit ankimohen në Kolegjin e Apelimeve nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.”.

Si rrjedhojë, duke qenë se unë nuk e pranoj Vendimin nr. 350, datë 23.02.2021 të KPK-së, nëpërmjet të cilit është vendosur në mënyrë të padrejtë shkarkimi nga detyra e gjyqtares, do të ushtroj të drejtën kushtetuese dhe ligjore të ankimit ndaj këtij vendimi, në Kolegjin e Apelimeve, brenda afatit ligjor, që përkon me datën 09.04.2021.

Në nenin 48, në paragrafët 7 dhe 8 të ligjit nr. 96/2016, parashikohet se: “7. Këshilli verifikon kandidatët, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji. 8. Vetëm kandidatët të cilët kalojnë verifikimin e pasurisë dhe figurës dhe që nuk kanë masa disiplinore në fuqi, pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë.

Mbështetur në këtë parashikim ligjor, pyetja që ngrihet është:

Nëse shkarkimi nga detyra i vendosur nëpërmjet vendimit {...}, datë 23.02.2021 të KPK-së, a mund të vlerësohet “masë disiplinore në fuqi” me efekt juridik të menjëhershëm, që të legjitimojë KLGJ-në të ndërpresë procedurën e nisur për ngritjen në detyrë të subjektit kandidues, duke e skualifikuar nga kandidimi?

Në nenin 62, paragrafi 1, të ligjit 84/2016 parashikohet se “Subjekti i rivlerësimit, i cili ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit të Komisionit për masën disiplinore për shkarkimin nga detyra, pezullohet ‘ex lege’ nga detyra e tij në pritje të vendimit të Kolegjit të Apelimeve.”.

Gjithashtu, risjell nenin 63, pika 1 të ligjit 84/2016 sipas të cilit: “1. Të gjitha vendimet e Komisionit ankimohen në Kolegjin e Apelimeve nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.”.

Nga këto norma ligjore determinohet një moment me rëndësi thelbësore juridike në drejtim të fuqisë së vendimit të KPK-së.

Siç konstatohet, ligjvënësi ka synuar kontrollin e vendimeve të këtij komisioni, te Kolegji i Apelimeve, në rast se paraqitet ankim nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik. Rrjedhimisht, mbështetur në logjikën juridike ligjore te sqaruar më lart, vendimi i KPK-së nuk mund të vlerësohet një vendim i formës së prerë, dhe masa

disiplinore eventuale e përmbajtur në të, nuk mund të konsiderohet “në fuqi” në kuptimin e prodhimit të pasojave të parashikuara në aktet ligjore, siç mund të jetë dhe ndërprerja e procedurës së mëtejshme të ngritjes në detyrë të subjektit të rivlerësimit, sipas paragrafit 8 të nenit 48 të ligjit nr.96/2016.

Në momentin kur çështja ka ezauruar dhe konsumuar të gjithë nivelet e ankimit, vendimi bëhet përfundimtar dhe i pandryshueshëm. Pikërisht ky vendim i fundëm, drejtësia e të cilit nuk mund të vihet në diskutim nga askush dhe nga asgjë përbën institutin ligjor të gjësë së gjykuar apo ‘res iudicata’.

Vendimi i formës së prerë përbën një zgjidhje të natyrës përfundimtare dhe të qëndrueshme të çështjes, si në kuptimin konstitiuv, ashtu dhe atë prekluziv, d.m.th. krijon situatën juridike të prekluzivitetit të ankimit dhe njëherazi edhe finalitetin e një zgjidhje ligjore, duke i dhënë fuqinë e plotë juridike masës disiplinore, apo duke e ndryshuar atë. Prandaj dhe ligjvënësi në nenin 66, paragrafi 3 të ligjit 84/2016, parashikon se “3.Vendimi i Kolegjit të Apelit, që vendos shkarkimin nga detyra, ka efekt të menjëhershëm ex lege”.

Kjo normë përforcon parashikimet ligjore të mësipërme, duke konkluduar se është vendimi i Kolegjit të Apelit, i formës së prerë, me plotfuqinë e prodhimit të pasojave në mënyrë të menjëhershme.

Sa më sipër, vetëm nëse Kolegji i Apelit vendos lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, atëherë do të quhet që për atë subjekt ka “masë disiplinore në fuqi”.

Po t’i rikthehem parashikimit të nenit 62, paragrafi 1, të ligjit 84/2016 sipas të cilit “Subjekti i rivlerësimit, i cili ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit të Komisionit për masën disiplinore për shkarkimin nga detyra, pezullohet ‘ex lege’ nga detyra e tij në pritje të vendimit të Kolegjit të Apeliteve”, konstatohet se logjika e ligjvënësimit në këtë normë është simetrike me parashikimin e nenit 449 të Kodit të Procedurës Civile sipas të cilit “Ekzekutimi i vendimit të ankimit pezullohet deri në përfundim të shqyrtimit në gjykatën e apelit, përveçse kur me ligj parashikohet ndryshe...”.

Vlerësoj që nocioni “i pezullimit” i prezantuar në nenin 62, duhet të vlerësohet në kontekstin e të gjithë përmasave kushtetuese dhe ligjore, të drejtave dhe detyrimeve, që i janë atribuar statusit të gjyqtarit në Republikën e Shqipërisë.

Ligjvënësi nëpërmjet kësaj norme, nuk synon, vetëm pezullimin nga detyra, në kuptimin e ushtrimit të funksionit të dhënies së drejtësisë, por, invokon pezullimin e universalitetit të të drejtave dhe detyrimeve të gjyqtarit, materiale dhe procedurale, në kontekst më të gjerë.

Kjo përforcohet edhe nga parashikimi i mëtejshëm i këtij neni, i cili në fjalinë e fundit parashikon që: “Gjatë periudhës së pezullimit atij i njihet e drejta e pagës në masën 75 për qind të saj, në përputhje me nenin F, pika 5, të Aneksit të Kushtetutës.”

Pra, ligjvënësi ka pranuar situatën e “pezullimit” dhe jo të “ndërprerjes” të statusit të subjektit të rivlerësimit, në rastin e “shkarkimit nga detyra” me vendim të KPK-së, deri në marrjen e vendimit të Kolegjit të Apelit. Pezullimi nuk do të thotë detyrimisht shkarkim përfundimtar nga detyra, ai është vetëm një masë e përkohshme, e cila zgjat deri në marrjen e formës të prerë të vendimit.

Rrjedhimisht, në rrethanën kur subjekti i rivlerësimit, ka ushtruar të drejtën e tij për zhvillimin e karrierës, duke paraqitur kandidimin për ngritje në detyrë, dhe ndërkaq, ndaj tij, KPK-ja vendos marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, kjo masë disiplinore ende nuk ka fuqinë juridike, që të passjellë ndërprerjen e procesit të kandidimit, por, efekti i saj, duke u mbështetur në normat e sipërcituara, është “pezullimi ipso legge” prej KLGJ-së të procedurës së kandidimit. Ky pezullim krijon një kufizim preventivues apo konservues të të drejtave subjektive të subjektit kandidat, duke ruajtur dhe standardet kushtetuese të nenit 17 të Kushtetutës. Pezullimi i kësaj procedure, për shkak të ngjarjes procedurale të ankimit ndaj vendimit të KPK-së, është një gjendje juridike që “ngrin” çdo veprimtari procedurale të KLGJ-se për të vazhduar më tej procesin e filluar për ngritjen në detyrë, deri në marrjen e vendimit prej Kolegjit të Apelit.

Lidhur me papajtueshmëria me parimin e sigurisë juridike dhe ankimit efektiv.

Vendimi eventual i KLGJ-së për skualifikimin e kandidaturës sime ndaj të drejtës për kualifikimin profesional, derisa vendimi i KPK-së nuk ka fituar autoritetin e formës

së prerë, do të përbënte një vendim që do të binte ndesh me disa elementë të procesit të rregullt ligjor, si një ndër parimet kryesore jetëdhënëse të shtetit të së drejtës.

Gjendja e pezullimit të kandidaturës që gjykoj se duhet të vendoset prej KLGJ-së në rastin konkret, është në pajtim, ndër të tjera, dhe me konkluzione dhe qëndrime të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

Kjo e fundit me vendimin nr. 34/2017 është shprehur se “...Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta e individit për një proces të rregullt ligjor, parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, nuk është e kufizuar vetëm në procesin gjyqësor, por përfshin edhe atë me karakter disiplinor administrativ. Në këtë kuptim, ajo ka theksuar se çdo organ i pushtetit publik, gjatë ushtrimit të funksionit të tij kushtetues e ligjor, është i detyruar të respektojë standardet demokratike, të cilat kanë gjetur pasqyrimin e tyre në Kushtetutë. Neni 42 i Kushtetutës sanksionon në vetvete jo vetëm të drejtën e individit për t’iu drejtuar gjykatës, por edhe detyrimin e shtetit që t’ia garantojë atij këtë akses. Detyrimi për të garantuar të drejtën efektive të aksesit në gjykatë nuk nënkupton thjesht mungesën e një ndërhyrjeje, por mund të kërkojë ndërmarrjen e veprimeve pozitive nga ana e shtetit. Në rast se mohohet një e drejtë e tillë, procesi konsiderohet jo i rregullt, sepse aksesit në gjykatë është para së gjithash një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera”.

Duke iu referuar edhe vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 43/2015, rastet e shkarkimit duhet të shoqërohen me garanci konkrete procedurale, me qëllim që zyrtari i shkarkuar të gëzojë një proces të rregullt ligjor, në përputhje me nenin 42 të Kushtetutës. Më tej, kjo gjykatë arsyeton se gjatë procesit të verifikimit të veprimtarisë së tij, nëse ka qenë në përputhje apo jo me Kushtetutën dhe ligjet e vendit, ai, ashtu si çdo funksionar tjetër, duhet të gëzojë disa garanci kur ndaj tij fillon një procedurë shkarkimi.

Gjykata vlerëson se parimi i sigurisë juridike mbron garancitë që rrjedhin nga neni 138 i Kushtetutës. Gjykata ka theksuar se siguria juridike është ndër elementet thelbësore të shtetit të së drejtës. Qëllimi i parimit të sigurisë juridike është të sigurojë besimin e personave të shteti e ligji dhe vetë gjyqtarët, të cilët administrojnë drejtësinë, duhet të gëzojnë një besim të tillë. Ligjvënësi ka detyrimin të rregullojë, në mënyrë më të hollësishme, të drejtat dhe garancitë e parashikuara në Kushtetutë. Gjithashtu, gjykata ka

theksuar se parimi i shtetit të së drejtës, i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, është një nga parimet themelore.

Vlerësoj se pezullimi i procedurës së kandidimit është gjendja e duhur procedurale që duhet të vendoset nga KLGJ-ja, nisur nga egzigjenca që imponon e drejta për proces të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. ...

Lidhur me papajtueshmërinë me parimin e barazisë.

Nga ana tjetër, skulifikimi i kandidaturës sime nga procesi për ngritje në detyrë në Gjykatë të Lartë, do të cenonte parimin e barazisë shprehur në nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë sipas të cilit: “1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale apo përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive”.

Kjo dispozitë kushtetuese vendos një nga parimet bazë të shtetit të së drejtës dhe riafirmon një nga parimet themelore të sanksionuara në KEDNJ sipas të cilit të gjithë personat duhet të kenë një akses të barabartë dhe të drejtë në mundësitë që paraqiten në një shoqëri.

Duke iu rikthyer situatës konkrete, pika 7 e vendimit nr. 75/2019 të KLGJ-së krijon një situatë pabarazie ndërmjet subjekteve të përfshirë në procesin e ngritjes në detyrë, kur ndaj njërit subjekt është vendosur prej KPK-së masa e shkarkimi nga detyra, dhe i cili ka paraqitur ankim në Kolegjin e Apelit, dhe ndaj tjetrit subjekt është vendosur konfirmimi në detyrë, por, prej Komisionerit Publik është paraqitur ankim në Kolegj.

Të dy llojet e vendimeve të lartpërmendura nuk janë të formës së prerë, ndërsa sipas pikës 7 të vendimit nr. 75/2019 të KLGJ-së, kjo e fundit ndaj të parit, do të vendosë skualifikimin nga procesi, dhe ndaj të dytit do të vijojë me zhvillimin e procesit. Kjo vendimmarrje krijon një barrë të pabarabartë procedurale ndërmjet subjekteve, që reflektohet në cenimin e të drejtave të tyre subjektive për kualifikim profesional, ngritur në nivel kushtetues në nenin 49/1 të Kushtetutës. Kjo vendimmarrje ofron favore dhe

dobi procedurale ndërmjet subjekteve kandiduese në mënyrë shpërpjesëtimisht të pabarabarta. ...

Lidhur me papajtueshmërinë me parimin e prezumimit të pafajësisë.

Në kuptimin klasik, e drejta për t'u prezumuar i pafajshëm është një e drejtë me karakter procedural dhe nënkupton të drejtën e një personi, të dyshuar për kryerjen e një veprë penale, për të mos u konsideruar fajtor para se të deklarohet si i tillë me vendim gjyqësor të formës së prerë. Këtë parashikim e gjejmë dhe në nenin 30 të Kushtetutës, sipas të cilit “Kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë”.

I sanksionuar në Kushtetutë, parimi i prezumimit të pafajësisë shpallet, si një ndër të drejtat themelore të njeriut. Në jurisprudencën e konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese, parimi i prezumimit të pafajësisë është konceptuar si një ndër elementet e rregullsisë së një procesi gjyqësor.

Kjo Gjykatë, e ka interpretuar prezumimin e pafajësisë në kuptimin që gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit, se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova direkte dhe indirekte që duhet të provohen nga akuza.

Po ashtu, në nenin 32/1 të Kushtetutës shpallet si e drejtë themelore e drejta për të mos u vetëinkriminuar apo “e drejta e heshtjes”, e cila është pasojë e drejtpërdrejtë e të drejtës për t'u prezumuar i pafajshëm.

Jurisprudenca kushtetuese shqiptare bazuar në jurisprudencën e GJEDNJ e ka trajtuar parimin e prezumimit të pafajësisë, si një garanci procedurale jo vetëm në procesin penal, por edhe në procedurat administrative.

Në këtë kuptim, është pranuar që mundësia e shkeljes së këtij parimi mund të shfaqet si në gjykata, ashtu edhe nga autoritete publike, duke e zhveshur këtë parim vetëm nga domethënia penale.

Interpretimi i zgjeruar, edhe tej procesit penal, merr një rëndësi të veçantë për sa i përket garantimit të të drejtave të parashikuara në KEDNJ, në mënyrë praktike dhe efektive, jashtë kontekstit teorik ose iluziv. Nëse e hedhim vështirimin në rendin juridik

shqiptar, mund të themi se nuk ekziston një parashikim, që ta trajtojë shprehimisht të drejtën për t'u prezumuar i pafajshëm, si një të drejtë subjektive, jo vetëm si një e drejtë procedurale, dhe jo vetëm në aspektin penal. Por kjo nuk do të thotë që kuadri ligjor shqiptar nuk lejon trajtimin e parimit të prezumimit të pafajësisë, si një të drejtë substanciale (materiale) e për rrjedhojë mbrojtjen në aspektin administrativ dhe civil të saj, dhe jo vetëm në aspektin penal.

Në thelb, prezumimi i pafajësisë, si një e drejtë materiale, është pjesë e të drejtave të personalitetit, me karakter jopasuror, absolut, që janë ngushtësisht të lidhura me njeriun. Ai ka për objekt nderin, dinjitetin dhe reputacionin njerëzor, që janë vlerat më të rëndësishme të një shoqërie që aspirojnë të jetë demokratike, sikurse është edhe shoqëria shqiptare.

Shteti shqiptar, me miratimin e Kushtetutës të vitit 1998, është zotuar t'i mbrojë dhe t'i garantojë këto vlera, duke i vendosur në bazat e tij. Të drejtat e personalitetit njerëzor, janë të pandashme, të patjetërsueshme, të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik.”

Këto janë në mënyrë të përmbledhur, po jo shumë të përmbledhur sepse unë u përpoqa të citoja të plotë të gjithë kundërshtimet e kandidatës. Ky është qëndrimi. Në fund të pretendimeve të saj kandidatja, si konkluzion, kërkon pezullimin ‘ipso legge’ prej Këshillit të Lartë Gjyqësor të procesit të kandidimit për emërimin/ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, deri në datën e marrjes së vendimit prej Kolegjit të Apelit, mbi bazën e ankimit që unë do të ushtroj, -thotë kandidatja, -brenda afatit ligjor, ndaj vendimit nr. 350, datë 23.02.2021 të Kolegjit të Pavarur të Kualifikimit”.

Ky është qëndrimi dhe ky është konkluzioni përfundimtar i parashtruar nga zonja {...}, që juve ju është vënë prej disa kohësh në dispozicion.

Duke vlerësuar të plotë procedurën e verifikimit për kandidaten, në lidhje me kriterin e kandidimit “të mospasjes masë disiplinore në fuqi”, me cilësinë e relatores ia kam parashtruar rastin Komisionit të Zhvillimit të Karrierës. Ky Komision, në mbledhjen e datës 30.03.2021, duke e konsideruar të plotë procedurën e verifikimit për kandidaten znj. {...}, në lidhje me kriterin e kandidimit “të mospasjes masë disiplinore në fuqi”,

përcaktuar nga pika 8, e nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe duke vlerësuar se aktualisht, për kandidaten, verifikohet një e dhënë e re në lidhje me një prej kritereve formale të kandidimit, mbi të cilin, Këshilli, kryesisht, bazuar në nenet 113 dhe 114 të Kodit të Procedurave Administrative, me qëllimin rivendosjen e ligjshmërisë, duhet të shqyrtojë ligjshmërinë e Vendimit të tij nr. 330, datë 17.09.2020, e dhënë kjo, që nga ana tjetër, mund të passjellë edhe skualifikimin e kandidates nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë, bazuar në pikën 3, Seksioni C, Kreu VI, të Vendimit nr.75/2019, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur ky i fundit për shfuqizimin e Vendimit nr. 330, datë 17.09.2020 dhe skualifikimin e kandidates dhe përjashtimin e saj nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë ose për vijimin e procedurës së verifikimit lidhur me këtë candidate.

Unë me cilësinë e relatores, sikurse jam shprehur edhe më parë në një rast tjetër kur është verifikuar e njëjta e dhënë, pra që lidhej me një candidate tjetër, konstatoj se për kandidaten znj. {...} është verifikuar një rrethanë që çon në përfundimin e mospërbushjes së saj të një prej kritereve të kandidimit, pikërisht atë të mospasjes masë disiplinore në fuqi, përcaktuar në pikën 8, të nenit 48 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Kjo rrethanë lidhet me faktin e shkarkimit nga detyra të kandidates me vendimin nr. 350, datë 23.02.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pra nga organi që është i ngarkuar nga Kushtetuta për kryerjen e procesit të vlerësimit.

Shkarkimi nga detyra përbën masë disiplinore në kuptim të legjislacionit në fuqi, çka përcaktohet shprehimisht në nenit 58, pika 1, sikundër edhe nenin 60 të ligjit 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligj i cili rregullon procesin e rivlerësimit dhe masat disiplinore që mund të ndërmerren në kuadër të tij, përfshirë edhe ndaj gjyqtarëve subjekt të rivlerësimit ex officio sipas nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Duke pasur në konsideratë faktin se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për dhënien e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra” është një vendim,

pasojat juridike të të cilit fillojnë menjëherë me njoftimin e tij, duke përberë ai shkak për ndërprerjen e menjëhershme të ushtrimit të detyrës ndaj një gjyqtari subjekt rivlerësimi ndaj të cilit ai është marrë.

Në pikën 7, të nenit 179/b të Kushtetutës, përcaktohet se: “Moskalimi me sukses i procesit të rivlerësimit përbën shkak për mbarimin e menjëhershëm të ushtrimit të detyrës, krahas shfaqjeve të parashikuara në Kushtetutë”.

Pavarësisht se gjyqtari i shkarkuar nga detyra prek Komisionit të Pavarur të Kualifikimit vijon të ruajë statusin e magjistratit deri në shqyrtimin e çështjes nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, në rastin kur paraqitet ankim gjyqësor, ai ligjërisht është nën efektet e një mase disiplinore për sa kohë atij i ndalohet ushtrimi i detyrës.

Në kushtet kur për kandidaten verifikohet një e dhënë e re në lidhje me një prej kriterëve formale të kandidimit, çka ndikon në tërësi ligjshmërinë e vendimit të Këshillit nr. 330, datë 17.09.2020, me qëllim rivendosjen e situatës së ligjshmërisë, me cilësinë e relatores, vlerësoj se është vendi që kryesisht nga Këshilli të shfuqizohet ky vendim bazuar në nenet 113 dhe 114 të Kodit të Procedurave Administrative, dhe nga ana tjetër, pikërisht për shkak të të dhënës së re të verifikuar për kandidaten, në kushtet kur ajo aktualisht rezulton të ketë një masë disiplinore në fuqi, çka përbën pengesë për pranimin në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë, sipas pikës 8 të nenit 48 të ligjit 96/2016, i ndryshuar, vlerësohet që është vendi për skualifikimin e kandidates dhe përjashtimin nga procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira ku ajo ka kandiduar.

Ky është propozimi i relatores, por edhe i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, pasi ashtu sikurse e citova edhe më përpara, e gjithë procedura ka kaluar në verifikim nga Komisioni.

Është paraqitur bashkëlidhur relacionit edhe projektvendimi përkatës, ku propozohet: 1. Shfuqizimi i vendimit nr. 330, datë 17.09.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 87 datë 26.02.2020...”.

2. Skualifikimi i kandidatës znj. {...} dhe përjashtimi i saj nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 87, datë 26.02.2020.

Ky është propozimi Kryetare.

Naureda Llagami: Faleminderit, znj. Shehu lidhur me relatimin e detajuar të projekt-aktit.

Atëherë, unë do ftoja kolegët nëse kanë ndonjë koment ose ndonjë sugjerim. Ndryshe, nëse nuk kanë, kalojmë në procedurën e votimit.

Atëherë, kalojmë në votim të projekt-aktit?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Shfuqizimin e vendimit nr. 330, datë 17.09.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 87 datë 26.02.2020 dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”.

2. Skualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe përjashtimin e saj nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 87, datë 26.02.2020.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

4. Kundër vendimit mund të paraqitet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2021

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.06.2021)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për skualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe përjashtimin e saj nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:05 dhe mbaroi në orën 13:50.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)

10. Marçela Shehu (anëtare)

11. Erjon Muharremaj (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Aleksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 6. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
- 7. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për skualifikimin e kandidates znj. {...} dhe përjashtimin e saj nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin e radhës i cili ka të bëjë me skualifikimin e kandidates znj. {...} dhe përjashtimin e saj nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë. Edhe për këtë projekt-akt relatore është zonja Shehu.

Marçela Shehu: Faleminderit, Kryetare!

Me Vendimin nr. 85, datë 26.02.2020, Këshilli ka vendosur: “1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”.

Me Vendimin nr. 86, datë 26.02.2020, Këshilli ka vendosur: “1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”.

Të njëjtën gjë ka bërë edhe me Vendimin nr. 87, datë 26.02.2020.

Brenda afatit të kandidimit, lidhur me këto tre pozicione, ka kandiduar edhe zonja {...}, aktualisht gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Lidhur me verifikimin e plotësimit të kriterëve nga kjo kandidate, pas vendimit dhe procedurave përkatëse, fillimisht është caktuar relator zoti Toro dhe pas procedurës së verifikimit të realizuar, Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 213, datë 18.06.2020 ka vendosur verifikimin e plotësimit nga kandidatja të kriterëve ligjore, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicione të lira në fushën e së drejtës civile, shpallur me vendimet e Këshillit nr. 85 dhe nr. 86. Theksoj se zoti Toro ka qenë relator pikërisht për këto dy pozicione, pra për pozicionin nr. 85 dhe nr. 86 dhe vendimi 213 i Këshillit lidhet pikërisht me verifikimin e plotësimit nga kjo kandidate të kriterëve ligjore që lidhen me këto pozicione.

Më pas, nëpërmjet një kërkesë zoti Toro ka hequr dorë nga pjesëmarrja në procedurat e ngritjes në detyrë për ata kandidatë, konkurrimi i të cilëve interferonte me konkurrimin e bashkëshortes e znj. Toro. Në këto kushte, z. Toro ka hequr dorë edhe nga pjesëmarrja në procedurën e verifikimit ndaj {...}. Kjo kërkesë është miratuar me Vendimin përkatës nga Kryetarja e Këshillit.

Në këto kushte, pas shortit të hedhur, me Vendimin nr. 352, datë 24.09.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka vendosur të më caktojë mua si relatore në procedurën e verifikimit ndaj kandidates znj. {...}.

Në vijim, të verifikimit paraprak të tre kriterëve formale të kandidimit për {...}, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendim nr. 87, datë 26.02.2020 të Këshillit, bazuar në të dhënat e grumbulluara, me Vendimin e tij nr. 387, datë 07.10.2020, Këshilli vendosi:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 87, datë 26.02.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidates për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë.

Nga ana tjetër, për kandidaten {...} ka vijuar procedura e verifikimit për kriteret e kandidimit, pikërisht të pasurisë dhe të figurës, ndërsa Këshilli ka qenë në pritje të përfundimit me përparësi të procesit të rivlerësimit kalimtar për kandidaten. Gjatë kësaj procedure, me shkresën nr. {...} prot., datë 02.04.2021, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njoftoi Këshillin për përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar për kandidaten {...}, si subjekt rivlerësimi “ex officio” sipas nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe se, me Vendimin nr. 364, datë 02.04.2021, ka vendosur: “Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. {...}, si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë”.

Mbas shqyrtimit të të dhënës së njoftuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, si dhe të dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit, në mbledhjen e datës 12.04.2021, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vendosi që kandidatja {...} të njoftohej për gjetjen e kësaj procedure në lidhje me një prej kriterëve të kandidimit për emërim/ngritjen në detyrë të gjyqtarit në Gjykatën e Lartë, pikërisht atë të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

Më datë 12.04.2021, kandidates në rrugë elektronike, i është dërguar Njoftimi “Për gjetjen e procedurës së verifikimit”.

Në Njoftimin “Për gjetjen e procedurës së verifikimit”, kandidates i është bërë e ditur se gjatë procedurës së verifikimit ishte evidentuar një rrethanë, e cila, bazuar në pikën 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, mund të passillte skualifikimin/ndalimin e kandidimit të saj për emërim/ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, e konkretisht ajo e “pasjes masë disiplinore në fuqi”.

Lidhur me rrethanën që mund të passillte skualifikimin/ndalimin e kandidimit të saj për emërim/ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, në Njoftimin “Për gjetjen e procedurës së verifikimit”, kandidates i është bërë e ditur se “Shkarkimi nga detyra”, me Vendimin nr. 364, datë 02.04.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, përbënte masë disiplinore në kuptim të neneve 58, pika 1, shkronja “c”, 61 dhe 62, të Ligjit nr.84/2016. Ndërkohë që, në pikën 8, të nenit 48, të Ligjit nr.96/2016, i ndryshuar,

përcaktohej se: “Vetëm kandidatët të cilët kalojnë verifikimin e pasurisë dhe figurës dhe që nuk kanë masa disiplinore në fuqi, pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë”. Kurse në pikën 7, Seksioni B, Kreun X, të Vendimit nr.75/2019, nxjerrë, ndër të tjera, edhe për zbatimin e neneve 32 dhe 48, të Ligjit nr.96/2016, përcaktohej se: “7. Kandidatët subjekt i procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr.84/2016, të cilët nuk janë konfirmuar në detyrë me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, edhe kur ndaj atij vendimi është paraqitur ankim, nuk pranohen të kandidojnë dhe nuk i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit sipas pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusin”.

Nëpërmjet Njoftimit “Për gjetjen e procedurës së verifikimit”, kandidates i është bërë gjithashtu me dije e drejta për t’u dëgjuar subjekti në një procedurë administrative, si dhe në zbatim të Vendimit nr.75/2019 i është bërë me dije se kishte të drejtën për të paraqitur shpjegime lidhur me gjetjen e procedurës së verifikimit, si dhe çdo dokumentacion mbështetës sipas vlerësimit të saj.

Bashkë me Njoftimin “Për gjetjen e procedurës së verifikimit”, kandidates i është dërguar edhe shkresa e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Me datë 19.04.2021, në rrugë elektronike, kandidatja kërkoi një afat të ri për dhënien e shpjegimeve. Bazuar në arsyet e parashtruara në këtë kërkesë, duke i vlerësuar ato të justifikuara, me cilësinë e relatores, bazuar në pikën 13, Seksioni B, të Kreu VI, të Vendimit nr. 75, datë 23.05.2019 të Këshillit, i kam bërë me dije kandidates afatin e ri për të paraqitur qëndrimet dhe shpjegimet lidhur me gjetjet e procedurës së verifikimit. Ky afat u caktua deri më datë 30.04.2021.

Ndërkohë, më datë 22.04.2021, kandidatja parashtroi kërkesë për përjashtimin e tre anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Kërkesa e kandidates, u shqyrtua nga Këshilli në Mbledhje Plenare më datë 26.04.2021. Me vendimin nr. 174 datë 26.04.2021 Këshilli ka vendosur: 1.Refuzimin e kërkesës së {...} për përjashtimin e relatores znj. Shehu në cilësinë e relatores, në çdo cilësi tjetër në procedurat për ngritjen në detyrë, të hapura me vendim nr. 85, nr. 86, nr. 87, datë 26.02.2020 të KLGJ-së, të iniciuara për shqyrtimin me vendim nr. 151, datë 06.05.2020, nr. 201, datë 11.06.2020 dhe nr. 243, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë

Gjyqësor. 2.Refuzimin e kërkesës për përjashtimin e anëtarëve të Komisionit z. Alban Toro dhe z. Ilir Toska, për të njëjtat procedura të parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi.

Brenda afatit të ricaktuar, më datë 30.04.2021, kandidatja ka depozituar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, shpjegime në lidhje me gjetjen e procedurës së verifikimit.

Në pjesën e parë kandidatja ka parashtruar të gjithë komunikimin që ka pasur me mua në cilësinë e relatores.

Në pjesën e dytë të parashtrimeve kandidatja ka cituar të gjithë bazën ligjore që ajo konsideron që duhet të konsiderohet nga Këshilli në rastin konkret gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të propozimit që ka Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Ka edhe pjesën e tretë të cilën unë do ta citoj të plotë, që kandidatja bën një arsyetim, një parashtrim lidhur me situatën.

Po citoj kandidaten si më poshtë:

“Procedura për anulimin ose shfuqizimin e vendimeve Nr. 387, datë 07.10.2020 dhe Nr. 213, datë 18.06.2020 të KLGJ-së, është absolutisht e pavlefshme dhe në alternative e paligjshme;

1. Nuk ka një vendim për rifillimin e një procedure rishqyrtimi të këtyre kritereve nga organi i caktuar me ligj, i cili ka të drejtën për shqyrtimin e ligjshmërisë po pavlefshmërisë absolute të aktit; Nëse ka, unë nuk jam njoftuar për një vendim të tillë megjithëse e kam kërkuar atë zyrtarisht siç mund të shihet nga komunikimi me Relatoren.

2. Një vendim i tillë, për rinisje shqyrtimi, duhej të merrej nga organi i cili ka shqyrtuar në themel këto pretendime dhe ka nxjerrë aktin administrativ, që është Këshilli dhe duhej të më njoftohej edhe mua;

3. Një vendim i tillë, për rinisje shqyrtimi, nuk mund të merret nga Komisioni i cili, pavarësisht se ka një procedurë të hapur për vlerësimin tim, nuk ka më kompetencë të vlerësojë ato kritere që janë vendosur nga Këshilli me akt administrativ, aq më pak nga relatorja;

4. Aktet administrative, vendimet Nr. 387, datë 07.10.2020 dhe Vendimi Nr. 213, datë 18.06.2020 të KLGJ-së janë në fuqi, kanë krijuar për mua të drejta të ligjshme dhe nuk ka asnjë procedurë, administrative apo ligjore që të lejojë organin administrativ t'i

rishqyrtojë ato. Revokimi si procedurë ekzistuese në Kodin e vjetër të Procedurës Administrative, nuk parashikohet më në Kodin e Procedurës Administrative në fuqi.

5. Në këtë procedurë, nuk po respektohet parimi i ligjshmërisë, neni 4/2 i Kodit të Procedurës Administrative, për arsyet e përmendura në pikën 4 më lart.

6. Argumentet për rivendosje të ligjshmërisë janë qesharake dhe foshnjore në njohuritë mbi të drejtën administrative. Paligjshmëria dhe pavlefshmëria e aktit janë të përcaktuara në nenin 107-114 të KPA. Mbetet për t'u imagjinuar se cilës dispozitë dëshiron në të ardhmen t'i referohet Komisioni, i cili do t'i paraqesë një raport Këshillit mbi këtë çështje. Pikërisht, për këtë shkak kam ngritur dhe kërkuar vendimin e nisjes së procedurës administrative, të cilën ju nuk e jepni dhe nuk e keni marrë, pikërisht se është ky vendim që duhej të bënte arsyetimin se përse procedura e mëparshme ishte e paligjshme apo e pavlefshme dhe bazën ligjore ku ajo mbështetej, si pjesë e arsyetimit të tij.

7. Nenet 113 dhe 114 të KPA, përcaktojnë jo vetëm procedurën dhe kompetencën e organit që vepron në këto raste, shkaqet e anulimit dhe shfuqizimit të aktit, por edhe pozicionin e palës që ka përfituar si e tillë që është në mirëbesim apo keqbesim. Nuk rezulton që ju t'i jeni referuar ndonjërit nga shkaqet e parashikuara në nenet 108 dhe 109 të KPA-së për të mbështetur këtë procedurë, në kuadër të vendosjes së ligjshmërisë. Ligjshmëria nuk mund të përcaktohet në mënyrë individuale nga organi administrativ por është e lidhur me kriteret e përcaktuara në nenin 109 të KPA, rastet që e bëjnë aktin të paligjshëm.

8. Kjo nuk është një procedurë e filluar me kërkesën time, pasi unë nuk kam paraqitur asnjë kërkesë për anulim apo shfuqizim të aktit administrativ, por një procedurë e filluar kryesisht nga organi administrativ, bazën ligjore të së cilës, unë nuk e di, sepse nuk më është njoftuar, por sipas ligjit detyrimi është i juaji të identifikoni dhe zbatoni, nëse ekziston.

9. Ju nuk keni një vendim për nisjen e procedurës së anulimit apo të shfuqizimit, i cili kërkohet nga neni 42 pika 1, e KPA-së dhe nuk mund të përfshihet në procedurën e kandidimit pasi qartazi është një procedurë e re, në mënyrë që të përcaktonin në atë vendim, pse ju konsideroni se pse akti, vendimet Nr. 387, datë 07.10.2020 dhe Nr. 213,

datë 18.06.2020 të KLGJ-së, janë të paligjshme dhe po nisni për to një procedurë anulimi apo shfuqizimi. Vetëm një procedurë e tillë do më krijonte mua mundësinë për të ushtruar efektivisht të drejtën për t'u dëgjuar dhe të drejtën e mbrojtjes (për sa kohë që po shfuqizohet apo anulohet një vendim në favorin tim), për të kundërshtuar ato që ju quani gjetje. Për më tepër, një procedurë dhe një vendim për shfuqizimin apo anulimin e aktit administrativ nuk mund të fillohet nga Komisioni. KPA kërkon që procedura të fillohet nga organi administrativ, që do të marrë vendimin përfundimtar, pavarësisht se cilat janë procedurat e brendshme të këtij organi, në përgatitjen dhe shqyrtimin e çështjes. Në mënyrë specifike për procedurat e anulimit dhe të shfuqizimit, kompetenca i takon organit që ka nxjerrë aktin, organit epror apo çdo organi të përcaktuar me ligj, pra qartazi jo Komisionit.

10. Nuk ka asnjë argument të parashtruar nga ana juaj në gjetjet tuaja që të shprehen pse aktet administrative, vendimet Nr. 387, datë 07.10.2020 dhe Nr. 213, datë 18.06.2020 të KLGJ-së, janë të paligjshme dhe nuk më rezulton që Kodi i Procedurave Administrative, të përcaktojë ndonjë rast paligjshmërie për to, në nenet 108 dhe 109 të tij. Për më tepër, rastet e pavlefshmërisë absolute dhe të paligjshmërisë (ajo që ne në doktrinën tonë e quajmë pavlefshmëria relative), nuk duket të kenë asnjë zbatim në nxjerrjen e vendimeve Nr. 387, datë 07.10.2020 dhe Nr. 213, datë 18.06.2020 të KLGJ-së.

11. Rastet e pavlefshmërisë apo paligjshmërisë së një akti administrativ, nuk mund të ndodhin pas nxjerrjes së aktit, por duhet të jenë të tilla që të kenë ekzistuar në kohën e nxjerrjes së aktit. Nuk rezulton që të jemi përpara një rasti të tillë.

12. Në përfundim, të analizës së mësipërme, nëse Këshilli i Lartë Gjyqësor dëshiron të anulojë apo shfuqizojë, vendimet Nr. 387, datë 07.10.2020 dhe Nr. 213, datë 18.06.2020 të KLGJ-së, ajo duhet t'i referohet dispozitave ligjore, të cilat përcaktojnë kushtet dhe kriteret për anulimin e akteve të ligjshme. Kur Këshilli i Lartë Gjyqësor të marrë një vendim për nisjen e një procedure të tillë, do të parashtrroj pretendimet e mia në atë procedurë.

Pjesa e dytë e arsytimit ligjor.

Vendimet e saj Nr. 387, datë 07.10.2020 dhe Nr. 213, datë 18.06.2020 të KLGJ-së janë vendime të ligjshme të marra në përputhje me procedurat dhe nuk rezultojnë të ketë ndonjë arsye ligjore anulimi apo shfuqizimi;

Vendimet Nr. 387, datë 07.10.2020 dhe Nr. 213, datë 18.06.2020 të KLGJ-së, janë marrë në përputhje me procedurën e përcaktuar në ligj dhe në aktin nënligjor përkatës, dhe konkretisht Vendimin Nr. 75, datë 23.06.2019 të KLGJ-ë, sipas kërësve përkatës dhe janë pranuar nga ana ime. Deri më tani, asnjë kontestim nuk ka pasur në lidhje me to. Ashtu siç ka parashtruar edhe relatorja në e-mail-in e saj të datës 15.04.2021, kriteret formale të: të “përvojës profesionale minimale”; të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, të vërtetuara këto edhe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor në Vendimet e saj Nr. 387, datë 07.10.2020 dhe Nr. 213, datë 18.06.2020 të KLGJ-së, janë një çështje tjetër dhe kriteret e tjera dhe konkretisht verifikimi i pasurisë dhe pastërtisë së figurës janë një çështje tjetër.

Fillimisht, le të konfirmojmë se unë i plotësoj të tria kriteret formale dhe s’kam asnjë masë disiplinore në fuqi, të dhënë sipas neneve 105 e vijues të Ligjit për Statusin, siç kërkohet nga nenin 48, pika 8, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “Vetëm kandidatët të cilët ... nuk kanë masa disiplinore në fuqi, pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë”.

Së dyti, për shkak se në procedurën e kandidimit në Gjykatën e Lartë vij pas një periudhe komandimi 5-vjeçare si Avokate e Përgjithshme e Shtetit, vlerësimin tim, për këtë periudhë e ka bërë organi ku jam komanduar, në përputhje kjo me Ligjin për Statusin.

Së treti, kalimi i procedurave të verifikimit të pasurisë dhe figurës - Siç mund të kuptohet edhe nga “gjetja” e Komisionit, situata faktike së cilës Komisioni i referohet ka të bëjë pikërisht me këto kritere dhe konkretisht për verifikimin e kriterit të pasurisë dhe jo me kriteret e sipërpërmendura, siç referohet në “gjetje”, pra kriterin e pasjes disiplinore.

Në lidhje me këtë çështje, pra, verifikimin nga ana e KLGJ-së të pasurisë dhe figurës dhe situatës së krijuar pas vendimmarrjes së KPK-së, më datë 2 prill 2021, parashtroj:

1. Ashtu siç rezulton nga e-mail-et e mia nuk ka asnjë dijeni që Këshilli i Lartë Gjyqësor të ketë marrë ndonjë vendim, që verifikimin tim për kriterin e pasurisë dhe figurës t'ia këtë kërkuar organeve të rivlerësimit, sipas Kreu X, germa B, pika 2,të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” duke përjashtuar procedurën e verifikimit të pasurisë dhe të figurës nga Këshilli, sipas përcaktimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusin. Nëse unë do të kisha një vendim të tillë, unë do të kisha edhe të drejtën time të ankimit ndaj tij, si diskriminues në procedurën e emërimeve në Gjykatën e Lartë, por nuk e kam dhe kam kërkuar që të më njoftohet.

2. Nëse një vendim i tillë do të merret, apo është marrë, Këshilli i Lartë Gjyqësor të specifikojë nëse ka pezulluar procedurën administrative që ka filluar në vijim të shpalljeve me Vendimet nr. 85, 86, 87 datë 26.02.2020 për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, ashtu siç kërkohet nga neni 66 i KPA.

3. Nëse jo, i kërkoj KLGJ-së, që nëse ka marrë një vendim apo do të marrë një vendim për shqyrtimin e kriterëve të pasurisë dhe figurës nga organet e rivlerësimit, të marrë një vendim sipas nenit 66/1 të KPA duke pezulluar procedurën deri në një vendim të formës së prerë nga ana e këtyre organeve. Konsiderimi i çështjes së verifikimit të pasurisë dhe figurës, nga organet e rivlerësimit, si një çështje paraprake, sipas nenit 66 të KPA, kërkon, në radhë të parë që KLGJ-ja të mos jetë kompetente për shqyrtimin e saj dhe për këtë të ketë kompetencë organi tjetër. Së dyti, kërkon një vendim pezullimi të procedurës, derisa organi kompetent të vendosi me vendim të formës së prerë.

4. Nga ana tjetër, nëse Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka marrë një vendim sipas Kreut X, germa B, pika 2, të Vendimit të saj nr. 75, datë 23.05.2019, në vendimet Nr. 387, datë 07.10.2020 dhe Nr. 213, datë 18.06.2020, përkatësisht në pikën 2, për shkak se KPK nuk po përfundon procedurat e rivlerësimit brenda 3 muajve nga momenti i paraqitjes së kërkesës, unë si kandidate i nënshtrohem procedurës së verifikimit të pasurisë dhe të figurës sipas përcaktimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusin, ju lutem të më sqarojë këtë vendim dhe të ma njoftojë atë. Mua më duhet t'i paraqes

alternative dhe hipotetike pretendimet e mia pikërisht sepse nuk sqarohem nga organi procedues, në kundërshtim me garancitë që më jep Kodi i Procedurave Administrative, mbi procedurat e ndjekura. Deri më sot unë kam konsideruar se Vendimet Nr. 387, datë 07.10.2020 dhe Nr. 213, datë 18.06.2020 të KLGJ-së, në pikën “2”, kanë përcaktuar se ajo po vijonte procedurat për verifikimin e këtyre kritereve nga ana e saj.

5. Në zbatim të nenit 48, pika 7 dhe 8 të Ligjit për statusin, verifikimi i pasurisë dhe figurës përbën një kriter tjetër të pavarur nga masa disiplinore.

6. Në zbatim të nenit 48, pika 7 dhe 8 të Ligjit për statusin, verifikimi i pasurisë dhe figurës është kompetencë e përcaktuar me ligj. Në zbatim të neneve 3 pika 5, nenit 22 pika 1, 2 dhe 3, neni 25, neni 28 dhe neni 29, i Kodit të Procedurës Administrative, KLGJ-ja është e detyruar të ushtrojë këtë kompetencë të përcaktuar me ligj. Delegimi në këtë rast nuk është i zbatueshëm pasi ai lidhet me qenien e organit të cilit i delegohet kompetenca, vartës i KLGJ-së.

Kreu X, germa B, i Vendimit të nr. 75, datë 23.05.2019, është absolutisht i pavlefshëm ose në alternative i paligjshëm, prandaj i kërkoj KLGJ-së ta anulojë apo shfuqizojë atë, me qëllim rivendosjen e ligjshmërisë.

1. Ky Kre është nxjerrë në kundërshtim me procedurën e kërkuar në ligj, përtej kompetencave që ligji i ka dhënë KLGJ-së dhe për rrjedhojë në kundërshtim me Kushtetutën. Antikushtetutshmëria, pavlefshmëria absolute ose paligjshmëria e Kreut X, shkronja B, e vendimit Nr. 75, datë 23.05.2019, të KLGJ-së rezulton për arsyet si më poshtë: së pari, sepse vjen në kundërshtim me autorizimet e dhëna nga neni 48, pika 14 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për KLGJ-në për të nxjerrë akte nënligjore dhe për rrjedhojë në kundërshtim edhe me parashikimet e nenit 118/2 të Kushtetutës, për sa i takon çështjeve që ligji ka autorizuar për të rregulluar me vendimin e KLGJ-së. Në nenin 118/2 të Kushtetutës parashikohet se: “2. Ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte.” Në nenin 48/14 të Ligjit nr. 96/2016 për Statusin, parashikohet se: “14. Këshillat miratojnë rregulla më të detajuara, të cilat përcaktojnë: a) kriteret për etikën dhe veprimtarinë profesionale ndërmjet kandidatëve me pikë të barabarta

vlerësimi; b) kriteret për vlerësimin e përvojës profesionale që kërkohet për pozicionin e lirë; c) procedurën që ndiqet në rastin e pikëve të barabarta; ç) zbatimin dhe përshtatjen e parashikimeve të këtij neni për pozicionet e lira të përkohshme.”

Pra, neni 48 i të Ligjit nr. 96/2016 për Statusin, i ndryshuar, ka autorizuar Këshillin e Lartë Gjyqësor të nxjerrë akte nënligjore vetëm në çështjet e parashikuara në pikën 14 të tij, jo për çështje të tjera, apo për vendosjen e kriterëve të reja, interpretimin e zgjeruar të kriterëve, etj. Për më tepër, neni 48 i Ligjit nr.96/2016 në asnjë rast nuk e ka autorizuar KLGJ-në të krijojë një akt nënligjor për të mos ushtruar kompetencën e dhënë me ligj për verifikimin e pasurisë dhe figurës së kandidatëve në procedurat e ngritjes në detyrë. Aq më pak e ka autorizuar që me akt nënligjor të krijojë procedura të ndryshme për verifikimin e pasurisë dhe të figurës duke krijuar diskriminim midis kandidatëve në procedurë, konkretisht në një grup i cili do t'i nënshtrohet procedurave të rivlerësimit sipas ligjit 84/2016. Për sa më sipër dhe në përputhje me nenin 109 germa “ç”, nenin 113 dhe nenin 114/1 ky akt të shfuqizohet nga KLGJ-ja për të rivendosur ligjshmërinë, pra kërkohet shfuqizimi i Kreut X, germa B, i Vendimit nr. 75, datë 23.05.2019;

2. Ky Kre i lejon KLGJ-së që me akt nënligjor të anashkalojë kompetencën e përcaktuar në ligj duke mos e ushtruar atë, veprim ky në kundërshtim me nenin 14, parimi i ligjshmërisë, nenin 25 ndalimi i heqjes dorë nga kompetenca, të Kodit të Procedurës Administrative, nenin 66 dhe për rrjedhojë është absolutisht i pavlefshëm sipas nenit 108, germa (a), pika (i) të Kodit të Procedurave Administrative;

3. Ky Kre cenon parimin e trajtimit të barabartë në një procedurë administrative dhe për rrjedhojë është diskriminues; Kreu X, shkronja B, i Vendimit Nr. 75, datë 23.06.2019 është diskriminues duke bërë në tërësi procedurën që ndjek KLGJ-ja për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, të krijuara me Vendimin Nr. 75, datë 23.06.2019 të KLGJ-së diskriminuese. Këto procedura trajtojnë në mënyrë të ndryshme dhe vendosin kriteret të ndryshme për kandidatët në të njëjtën procedurë për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, pa një shkak ligjor. Kështu, procedurat janë të ndryshme, për a) kandidatët që vijnë nga jashtë sistemit dhe b) për kandidatët që janë brenda në sistem, pa një shkak ligjor. Pavarësisht se, KLGJ-ja është kompetente për të verifikuar këtë kriter për të gjithë kandidatët , dhe në funksion është procedura dhe organet e rivlerësimit të

krijua me ligjin nr.84/2016, në procedurat e të cilëve do të kalojnë 'ex-officio' jo vetëm gjyqtarët por edhe ndihmësit ligjorë, inspektorët e KLD-së, etj., KLGJ-ja nuk ia nënshtron procedurat e vlerësimit të pasurisë dhe të figurës për anëtarët e Gjykatës së Lartë që vijnë nga jashtë sistemit procedurave të ligjit 84/2016. Një përcaktim i tillë bëhet pikërisht në vendimin Nr. 75, datë 23.06.2019 të KLGJ-së. Ndërkohë, të diferencuara janë edhe procedurat për kandidatët brenda sistemit, duke u nisur nga koha e veprimit të organeve të rivlerësimit, pra për shkaqe tërësisht të pavarura nga ata. Kështu a) për kandidatët subjekte të procedurave të rivlerësimit që kanë marrë një vendim të formës së prerë, KLGJ-ja i përmbahet pikërisht këtij vendimi për periudhën dhe do të bëjë vetë vlerësimin për periudhën e mëpasshme deri në kandidim, ndërsa b) për kandidatët subjektet të procedurave të rivlerësimit, që janë në procedurë apo nuk kanë filluar ende procedurën, KLGJ-ja në vendimin 75, përcakton se do t'i referohet vendimit të KPK-së, pavarësisht se ky vendim nuk është i formës së prerë. Pra, subjektet nga jashtë sistemit, nuk i nënshtrohen procedurave të rivlerësimit, por vetëm verifikimit të KLGJ-së; subjektet që kanë vendim të formës së prerë (pavarësisht se mund të jenë shkarkuar nga KPK-ja dhe vendimi është prishur vendimi nga KPA-ja) i nënshtrohen vendimit të formës së prerë të rivlerësimit dhe verifikimit të KLGJ-së; ndërsa subjektet në procedurë rivlerësimit, duhet të ketë vendimin pozitiv nga KPK-ja, vendimin pozitiv nga KPA-ja, pra vendim pozitiv të formës së prerë dhe verifikim nga KLGJ-ja për periudhën shtesë nëse ka. Nuk kuptohet arsyeja ligjore pse vendimi 75, përcakton se subjektet në procedurë duhet të kenë dy vendime pozitive, dhe nuk mjafton vendimi pozitiv i formës së prerë për ta. Për rrjedhojë, procedura është qartazi diskriminuese, në kundërshtim me nenin 17/2 të Kodit të Procedurës Administrative, nenin 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe nenit 17 pika 2 të Kushtetutës, i cili ka përcaktuar se standardet e vendosura në KEDNJ janë standarde minimum. Pra, për këta subjekte pavarësisht se çfarë do të vendosë KPA në vendimin e saj përfundimtar mbi procedurën, ky fakt është i pamjaftueshëm për KLGJ-në dhe ajo e skualifikon kandidatin përkatës paraprakisht. Pra, një kandidati të tillë i nevojitet të ketë dy vendime pozitive nga organet e rivlerësimit, edhe vendimin e KPK dhe vendimin e KPA-së në mënyrë që të mos skualifikohet dhe të vijojë procedurën. Një trajtim i tillë është i pabarabartë dhe diskriminues dhe në

kundërshtim me parimin e barazisë dhe të mosdiskriminimit të përcaktuar nga neni 17/2 i Kodit të Procedurave Administrative.

4. Për rrjedhojë Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet të anulojë ose shfuqizojë vendimin e saj Nr. 75, datë 23.06.2019, në lidhje me diferencat në procedurat e verifikimit të pasurisë dhe figurës për procedurat e ngritjes në detyrë apo emërimit në Gjykatën e Lartë. Sidomos KLGJ-ja duhet të anulojë ose të shfuqizojë kreun X seksioni B të vendimit Nr. 75, datë 23.06.2019, si i tillë që vjen në kundërshtim me Kushtetutën neni 118/2 dhe Ligjin për Statusin neni 48 pika 14 dhe dispozitat e Kodit të Procedurave Administrativ për kompetencën e organit administrativ. Ky akt është absolutisht i pavlefshëm sipas parashikimeve të nenit 108 germa “a”, paragrafi “i”, pasi vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me dispozitat e sipërcituara të Kushtetutës, Ligjit për Statusin dhe Kodin e Procedurave Administrative për kompetencën e organit administrativ, për të nxjerrë një akt të tillë dhe për të vendosur për të mos ushtruar kompetencat e ngarkuara me ligj. Në alternativë, ky akt është i paligjshëm sipas nenit 109 të Kodit të Procedurave Administrative, germa “ç”, pasi cenon të drejtat e ligjshme të shtetasve (konkretisht të drejtën për të marrë pjesë në një procedurë të ngritjes në detyrë) në mungesë të një autorizimi nga një ligj dhe që rezulton në një trajtim të pabarabartë, në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë dhe të barazisë në trajtim në një procedurë administrative.

Për rrjedhojë, kërkoj nga KLGJ që në zbatim të nenit 110, pika “2”, nenit 113 dhe nenit 114 të Kodit të Procedurës Administrative dhe me qëllim rivendosjen e ligjshmërisë dhe të barazisë në procedurat për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, si edhe në bazë të arsytimit të mësipërm, të anulojë ose shfuqizojë, Kreun X germa B, të vendimit Nr. 75, datë 23.06.2019 dhe çdo dispozitë tjetër të këtij vendimi që krijon trajtim të diferencuar në këto procedura në lidhje me verifikimin e kriterit të pasurisë dhe figurës.

Gjithashtu kandidatja parashtron se:

Vendimi i KPK-së nuk është i formës së prerë dhe për rrjedhojë nuk është i ekzekutueshëm.

1. Organet e rivlerësimit, procesi i rivlerësimit dhe efektet e vendimeve të tyre janë parashikuar në mënyrë të posaçme në Ligjin 84/2016, Ligji i Rivlerësimit. Vendimi i

Komisionit të Posaçëm të Kualifikimit dhe i KPA janë barazuar nga Ligji i Rivlerësimit më vendimet gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë Administrative dhe Gjykatës së Apelit Administrativ. Një barazim i tillë, vjen për shkak se sistemi i rivlerësimit, kërkonte të plotësonte detyrimin kushtetues, të drejtën për t'u ankuar ndaj një vendimi gjyqësor, të përcaktuar nga neni 43 i Kushtetutës. Vetëm konsiderimi i vendimit të KPK-së në vlerë të njëjtë me vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Administrative, plotëson këtë kriter, duke e konsideruar KPA-në si Gjykatë Apeli;

2. Vendimet gjyqësore të gjykatave të shkallës së parë nuk janë të ekzekutueshme, dhe për rrjedhojë nuk mund përdoren si referencë për vendimmarrje nga KLGJ-ja;

3. Ligji për rivlerësimin e ka përcaktuar vetë cila janë efektet e përkohshme të vendimit të KPK-së, dhe pikërisht, mosvijimi i gjykimit, dhe ulja e pagës në 75%. Për rrjedhojë, vendimi nuk mund të ketë efekte të tjera, të përkohshme, apo përfundimtare që nuk janë caktuar me ligj;

4. Ligji për rivlerësimin ka përcaktuar si vendim të ekzekutueshëm, vendimin e KPA-së;

5. Efektet e vendimit të KPK-së barazohen më situatën të ngjashme me atë të nenit 26 të Ligjit për Statusin kur ulet ngarkesa e magjistratit. Pavarësisht se në atë rast ulja e ngarkesës është e kufizuar, në këtë rast Kushtetuta dhe ligji kanë përcaktuar heqje totale të gjykimit të çështjeve, por jo efekte të tjera të vendimit;

6. Askush nuk mund të ekzekutojë një vendim gjyqësor që nuk ka marrë formë të prerë dhe aq më pak të kufizojë të drejta të ligjshme, siç është ajo e ngritjes në detyrë, që buron nga statusi i gjyqtarit, apo aq më pak të shfuqizojë akte administrative që kanë krijuar të drejta të ligjshme, siç janë vendimi Nr. 387, datë 07.10.2020 dhe vendimi 213, datë 18.06.2020.

7. Vendimi i KPK-së është një dënim administrativ, sipas një ligji tjetër, në një proces të përcaktuar në mënyrë të posaçme. Ai dënim administrativ ka për qëllim të cenojë statusin e gjyqtarit, dhe nuk mund të identifikohet me kriterin e “masave disiplinore” sipas ligjit për statusin, vetëm sepse terminologjia e përdorur është e ngjashme. Kuptimi i tij del nga ligji për rivlerësimin dhe nuk mund të tjetërsohet nga organet e tjera administrative, të cilat duhet t'i drejtohen atij ligji për kuptimin dhe fuqinë

e vendimmarrjes. Për rrjedhojë, e drejta ime e konkurrimit, në lidhje me procesin e rivlerësimit, lidhet pikërisht me pasjen ose jo të statusit të gjyqtarit. Për aq kohë sa nuk ka një vendim të formës së prerë për shkarkim, unë e gëzoj ende këtë status dhe të gjitha të drejtat që vijnë nga ai.

Si përfundime, kandidatja kërkon, bazuar në arsyet e mësipërme, kërkon nga Këshilli i Lartë Gjyqësor:

1. Rrëzimin e gjetjeve të Komisionit të Karrierës të komunikuara me e-mail-in e datës 12 prill 2021;

2. Anulimin ose shfuqizimin e Kreut X, germa B, të Vendimit të nr. 75, datë 23.05.2019, si absolutisht të pavlefshëm ose në alternativë të paligjshëm, me qëllim rivendosjen e ligjshmërisë;

3. Vijimin e procedurave të verifikimit të pasurisë dhe figurës sipas pikës “2” të Vendimeve Nr. 387, datë 07.10.2020 dhe Nr. 213, datë 18.06.2020 të KLGJ-së, nëse kjo pranon se ka kompetencë për këtë verifikim; Në alternativë, nëse KLGJ-ja gjen se nuk ka kompetencë dhe është e lidhur me përfundimin e çështjes paraprakisht nga organet e rivlerësimit, sipas nenit 66/1 të Kodit të Procedurave Administrative, pezullimin e procedurës, derisa organi kompetent të vendosi me vendim të formës së prerë.

4. Të drejtën për t’u dëgjuar verbalisht nga KLGJ-ja në lidhje me këtë kërkesë timen, për të njëjtat arsye që kam parashtruar në kërkesën time të datës 22 prill 2021 për përjashtimin e Komisionit të Karrierës nga procedurat e ngritjes në detyrë për rastin tim.”

Ky ishte i gjithë qëndrimi, pretendimet dhe kërkesat e parashtruara nga kandidatja zonja {...}. Këto pretendime dhe e gjithë situata është vlerësuar nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, procedura e verifikimit. Duke e vlerësuar të plotë procedurën e verifikimit për kandidaten zonjën {...} në lidhje me kriterin e kandidimit të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, përcaktuar në pikën 8, e nenit 48, të Ligjit nr.96/2016, me cilësinë e relatores ia kam parashtruar rastin Komisionit të Zhvillimit të Karrierës dhe ky Komision në mbledhjen e datës 11.05.2021 e ka konsideruar të plotë procedurën e verifikimit për kandidaten {...} në lidhje me kriterin e kandidimit të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” si dhe duke vlerësuar se aktualisht, për kandidaten, verifikohet një e dhëne e re në lidhje me një prej kriterëve formale të kandidimit, mbi të cilën, Këshilli,

kryesisht, bazuar në nenet 113 dhe 114 të Kodit të Procedurave Administrative, me qëllim rivendosjen e ligjshmërisë, duhet të shqyrtojë ligjshmërinë e Vendimeve të tij nr. 213 datë 18.06.2020 dhe nr. 387, datë 07.10.2020, e dhënë kjo, që nga ana tjetër, mund të passjellë edhe skualifikimin e kandidatës nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë, bazuar në pikën 3, Seksioni C, Kreu VI, të Vendimit nr. 75/2019, Komisioni ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur ky i fundit për shfuqizimin e Vendimeve të tij nr. 213 datë 18.06.2020 dhe nr. 387, datë 07.10.2020 dhe skualifikimin e kandidatës dhe përjashtimin e saj nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë ose për vijimin e procedurës së verifikimit për të.

Me cilësinë e relatores, edhe për zonjën {...} mbaj të njëjtin qëndrim sikurse edhe për kandidaten paraardhëse. Vlerësoj se aktualisht për zonjën {...} është verifikuar një rrethanë që çon në përfundimin e mospërbushjes së saj të një prej kriterëve të kandidimit, pikërisht të atij të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, që përcakton pika 8 e nenit 48, e Ligjit nr.96/2016. Kjo rrethanë e konstatuar rishtazi lidhet me faktin e shkarkimit nga detyra të kandidatës me vendimin nr. 364, datë 02.04.2021 të KPK-së. Kam këtë mendim pasi vlerësoj se vendimi i KPK-së për dhënien e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra” është një vendim, pasojat juridike të të cilit fillojnë menjëherë me njoftimin e tij për sa kohë ai bëhet shkak për ndërprerjen e menjëhershme të ushtrimit të detyrës nga ana e gjyqtarit. Pra, pavarësisht se gjyqtari i shkarkuar nga detyra prej KPK-së vijon të ruajë statusin e magjistratit deri në shqyrtimin e çështjes nga Kolegji, në rastin kur ai paraqet ankim, ai ligjërisht është nën efektet e një mase disiplinore, ndërsa për sa kohë atij i ndalohet ushtrimi i detyrës. Fakti që masa disiplinore e “Shkarkimit nga detyra” ndaj gjyqtarës nuk është marrë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas përcaktimeve të ligjit 96/2016 për Statusin, nuk mund të çojë në mosekzistencën e një mase disiplinore.

Me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë dhe të rikthehet besimi i publikut tek institucionet e këtij sistemi, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, me ndryshimet e vitit 2016, parashikoi ngritjen e sistemit të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, një proces ky i jashtëzakonshëm dhe tranzitor, që kryhet nga organet e pavarura kushtetuese dhe që ka për qëllim kontrollin e

ligjshmërisë së pasurisë, pastërtisë së figurës dhe të pasjes së aftësive minimale profesionale. Në kuadër të këtij procesi ligjor, Kushtetuta dhe ligji i dalë për zbatim të saj, ligji 84/2016 kanë konsideruar që, në raport me objektin e rivlerësimit kalimtar, KPK vepron si organ disiplinor mes gjyqtarëve dhe prokurorëve. Nisur nga kjo, vendimmarrja e këtij organi disiplinor, i dhënë brenda kompetencave të tij, nuk mund të anashkalohej dhe të mos merret në konsideratë, përfshirë edhe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Me vendimin nr. 2, datë 18.01.2017 Gjykata Kushtetuese është shprehur se: “22. I gjithë procesi i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si pjesë e paketës së reformës në drejtësi, edhe pse është një masë e jashtëzakonshme dhe me karakter të përkohshëm, është ngritur nga kushtetutëbërësi në rang kushtetues, duke parashikuar institucionet që do të kryejnë këtë proces, kompetencat e tyre, si edhe mënyrën e zgjedhjes së anëtarëve dhe garancitë që ata gëzojnë. Qëllimi i përcaktimit të kompetencave të këtyre organeve në mënyrë të drejtpërdrejtë në Kushtetutë do të thotë se asnjë institucion nuk mund të marrë këto kompetenca apo t'i anashkalojë ato.”.

Në kushtet kur për kandidaten verifikohet një e dhënë e re në lidhje me njërin prej kriterëve formale të kandidimit, çka afekton në tërësi ligjshmërinë e Vendimeve të Këshillit nr. 213, datë 18.06.2020 dhe nr. 387, datë 07.10.2020, me qëllimin rivendosjen e situatës së ligjshmërisë, vlerësohet se është vendi që, kryesisht nga Këshilli, të shfuqizohen këto vendime, bazuar në nenet 113 dhe 114 të Kodit të Procedurës Administrative.

Nga ana tjetër, pikërisht për shkak të të dhënës së re të verifikuar për kandidaten, në kushtet kur ajo aktualisht rezulton të ketë një masë disiplinore në fuqi, çka përbën pengesë për pranimin në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë, sipas pikës 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, vlerësoj se është vendi për skualifikimin e kandidates dhe përjashtimin nga procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira ku ajo ka kandiduar. Vlerësoj se në këtë rast nuk është i nevojshëm vijimi i procedurës së verifikimit të kandidates për kriteret e tjera, për sa kohë ligji parashikon se mosplotësimi qoftë edhe i një kushti apo kriteri passjell skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatit nga procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë.

Lidhur me atë çka pretendon kandidatja se nuk i takon Komisionit të iniciojë një procedurë administrative për shfuqizimin e një akti administrativ dhe për të vlerësuar për atë paligjshmëri, theksoj se Komisioni nuk ka vendosur në asnjë moment dhe nuk ka marrë një vendim ku të jetë shprehur që vendimet e Këshillit janë të paligjshme apo të pavlefshme, nuk ka vendosur anulimin apo shfuqizimin e tyre, sepse sigurisht që nuk e ka këtë kompetencë. Theksoj se deri në momentin që ky Këshill të vendosë shfuqizimin e tyre, ato vijojnë të jenë në fuqi, por Komisioni nuk ka bërë gjë tjetër përveçse atë çka bën gjithmonë gjatë procedurës së verifikimit në momentin që ka konstatuar një rrethanë e cila afekton dhe ndikon vijimin e procesit të verifikimit, ka bërë propozimet përkatëse dhe ia ka paraqitur ato Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Bazuar në të gjithë këto sa më sipër, unë kam përgatitur projektvendimin përkatës, ku në pikën 1 parashikohet/propozohet shfuqizimi i Vendimeve nr. 213 datë 18.06.2020 dhe nr. 387 datë 07.10.2020, të Këshillit. Ndërsa në pikën 2 propozohet skualifikimi i kandidates dhe përjashtimi nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë.

Faleminderit, Kryetare!

Naureda Llagami: Faleminderit Marçela për relatimin!

Do ftoja kolegët nëse kanë ndonjë diskutim apo koment lidhur me këtë gjë.

Nëse jo kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të bërë nga Komisioni?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Shfuqizimin e Vendimeve nr. 213, datë 18.06.2020 dhe nr. 387, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 85, nr. 86 dhe nr. 87, datë 26.02.2020 dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”.

2. Skualifikimin e kandidates znj. {...} dhe përjashtimin e saj nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 85, nr. 86 dhe nr. 87, datë 26.02.2020.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

4. Kundër vendimit mund të paraqitet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2021

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.06.2021)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për dhënie leje të papaguar gjyqtares {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brunilda Kadi).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:05 dhe mbaroi në orën 13:50.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)

10. Marçela Shehu (anëtare)

11. Erjon Muharremaj (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Aleksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 6. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
- 7. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për dhënie leje të papaguar gjyqtarës {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brunilda Kadi).

Naureda Llagami: Kalojmë pa humbur kohë me aktin tjetër, i cili ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për dhënie leje të papaguar gjyqtarës {...}”, projekt-akti i cili është përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale dhe do raportohet nga zonja Kadi.

Brunilda Kadi: Faleminderit, Kryetare!

Siç jeni vënë në dijeni, në datë 12.05.2021 zonja {...} e cila ushtron funksionin e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka paraqitur një kërkesë për t’i dhënë leje të papaguar për arsye familjare, shëndetësore, për një periudhë 40 ditë. Arsyeja, në mënyrë të përmbledhur, është gjendja shëndetësore dhe moshja e thyer e prindërve të saj, për të cilët ajo shprehet se është e vetmja që kujdeset, për shkak edhe të

faktit që kanë kaluar infeksionin e shkaktuar nga COVID-19 dhe po përballet me pasojat post COVID.

Me paraqitjen e kërkesës, nga ana e Komisionit është kryer procedura, pasi i është kërkuar gjyqtarës të qartësojë objektin e kërkesës, periudhën kur kërkon të fillojë dhe të depozitonte mendimin e zëvendëskryetarit. Nga ana e gjyqtarës është kthyer përgjigja që objekti është për arsye familjare shëndetësore sipas nenit 24 të ligjit 96/2016. Afati, nisur nga rrethanat dhe arsyet të për të cilat kërkon lejen, thotë që e kërkon në mënyrën më të shpejtë të mundshme, pra të fillojë sa më shpejt të jetë e mundur.

Me paraqitjen e mendimit të kryetarit të gjykatës, brenda afateve të përcaktuara në rregullore, Komisioni e trajtoi kërkesën dhe doli në konkluzionin që ajo plotëson kushtet dhe kriteret e përcaktuara në ligj dhe në rregullore dhe ka konkluduar që kjo kërkesë duhet të pranohet. Është paraqitur me shkrim. Koha për të cilën kërkohet është më pas se dy vjet që përcakton ligji. Periudha e fillimit është vlerësuar që të fillojë disa ditë mbas marrjes së vendimit nga seanca plenare, në hipotezën që pranohet kërkesa, me arsyetimin që 3-4 ditë i nevojiten gjyqtarës për të shpallur nëse ka ndonjë vendim në fazën procedurale të shpalljes së vendimit.

Nga ana e kryetarit të gjykatës, në fakt, përmbajtja e dhënies së mendimit të tij është më shumë informacion se në cilin seksion bën pjesë gjyqtarja, sa janë dosjet që ajo ka në shqyrtim dhe kërkon Këshillit që të shprehet në lidhje me faktin nëse duhet të përjashtohet gjyqtarja nga kjo periudhë treditore nga shorti.

Ndërkohë, nga ana e Komisionit është vlerësuar, duke qenë se kryetari nuk thotë në mendimin e tij që cenohet funksionaliteti i gjykatës me largimin e gjyqtarës për 40 ditë, prezumohet që është përgjigje pozitive dhe është propozuar që zonjës {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, t'i jepet leje e papaguar për arsye familjare shëndetësore për një periudhë 40-ditore. Në fakt në relacion dhe në projektvendim është vënë data 11 sepse është menduar që mund të trajtoheshe më shpejt, por në fakt bën sens dhe propozohet që leja të fillojë më datë 14 qershor, pra ditën e hënë dhe të përfundojë në datën 24 korrik 2021, pra më datë 24 korrik gjyqtarja duhet të fillojë ushtrimin e detyrës.

Në lidhje me hedhjen në short të çështjeve, duke qenë se periudha është e shkurtër, nga Komisioni është vlerësuar që çështjet të mbahen për shqyrtim nga gjyqtarja

dhe të mos rishpërndahen në short, përveç atyre që janë me afate ligjore gjykimi dhe për këtë është vlerësuar të ngarkohet kancelari i gjykatës që të kryejë verifikimin e tyre dhe të marrë masa për rihedhjen në short sipas parashikimeve të nenit 25, pika 3, shkronja /d/ e ligjit 98/2016.

Për sa i përket kërkesës së kryetarit të gjykatës është vlerësuar që kjo është e qartë në ligj. Gjyqtarja nuk mund të përfshihet në short gjatë kohës që është me leje të papaguar dhe është vlerësuar nga Komisioni që kjo të mos përcaktohet tek vendimi, pasi është e qartë nga ligji dhe prezumohet që edhe kryetari e ka të qartë këtë situatë.

Si përfundim, projektvendimi që propozohet për t'u votuar (po lexoj tekstin e dispozitivit, me saktësimin që sapo bëra në relativim):

1. Miratimin e kërkesës së znj. {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për dhënie leje të papaguar, për arsye familjare dhe shëndetësore, për një periudhë 40 (dyzet) ditore, e cila fillon më datë 14.06.2021 dhe mbaron në datën 24.07.2021.

2. Rindarjen me short të të gjitha çështjeve për të cilat ligji procedural parashikon afat ligjor dhe që gjyqtarja {...} i ka në shqyrtim në momentin e fillimit të lejes së papaguar.

3. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtarës {...} dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrativë të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimitetit. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, znj. Kadi!

Kemi ndonjë sugjerim nga kolegët?

Nëse jo, kalojmë në votimin e projekt-aktit?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Fatmira Luli: Dakord.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Miratimin e kërkesës së znj. {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për dhënie leje të papaguar, për arsye familjare dhe shëndetësore, për një periudhë 40 (dyzet) ditore, e cila fillon më datë 11.06.2021.

2. Rindarjen me short të të gjitha çështjeve për të cilat ligji procedural parashikon afat ligjor dhe që gjyqtarja {...} i ka në shqyrtim në momentin e fillimit të lejes së papaguar.

3. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtarës {...} dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrativë të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimitetit.

Brunilda Kadi: Kryetare, më fal që ju ndërpres!

Juve lexuat variantin e projektvendimit që ju është sjellë dhe në fakt unë propozova një saktësim duke thënë datën 14 (fillimin) dhe përfundimi ishte në datën 24.07 dhe kjo u hodh edhe në votim. Ndoshta për efekt të procesverbalit, duhet të saktësohet kjo.

Naureda Llagami: Ke shumë të drejtë. Ndjesë!

Atëherë, vetëm për pikën e parë po e lexoj edhe një herë:

1. Miratimin e kërkesës së znj. {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për dhënie leje të papaguar, për arsye familjare dhe shëndetësore, për një periudhë 40 (dyzet) ditore, e cila fillon nga data 14.06.2021 deri në datën 24.06.2021 (*muaji qershor është lapsus, në fakt duhet korrik 24.07.2021*).

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2021

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.06.2021)

Pika 8 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për komandimin e gjyqtarës znj. {...} në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:05 dhe mbaroi në orën 13:50.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)

10. Marçela Shehu (anëtare)

11. Erjon Muharremaj (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Aleksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 6. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
- 7. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për komandimin e gjyqtares znj. {...} në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për komandimin e gjyqtares znj. {...} në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, projekt-akt i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës dhe do raportohet nga zoti Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur projektvendimin “Për komandimin e gjyqtares znj. {...} në Këshillin e Lartë Gjyqësor”. Krahas projektvendimit ju është dërguar edhe relacioni shpjegues lidhur me arsyet e përgatitjes së këtij projektvendimi.

Shkurtimisht mund t’ju parashtroj se Këshilli i Lartë Gjyqësor, më herët me Vendimin nr. 200, datë 12.05.2021, miratoi vendimin për “Për shpalljen e kërkesës për

kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandimin në Këshillin e Lartë Gjyqësor, kohëzgjatjen, kushtet, kriteret dhe procedurën e komandimit”.

Brenda afatit të aplikimit për komandim, pikërisht më datë 26.05.2021, protokolluar në Këshillin e Lartë Gjyqësor me aktin {...}, aplikoi znj. {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Mbështetur në nenet 53 dhe 54, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e tij nr. 200, datë 12.05.2021, pas verifikimit të përmbushjes së kushteve të komandimit nga kandidatja znj. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin nr. 238, datë 02.06.2021, vendosi: “1. Miratimin e opinionit për përfshirjen e kandidates znj. {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në procedurat e komandimit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor. 2. Publikimin e këtij opinionit në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor. 3.

Aplikimi i kandidates znj. {...}i përcillet për vlerësim dhe përzgjedhje Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Në zbatim të pikës 3, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 238, datë 02.06.2021, por edhe të pikës 11, të Vendimit të tij nr. 200, datë 12.05.2021, me Shkresën nr. {...} prot., datë 03.06.2021, dokumentet e aplikimit të kandidates znj. {...}i janë përcjellë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për vlerësim dhe përzgjedhje.

Me Urdhrin nr. 39, datë 03.06.2021, bazuar në nenin 78 të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në pikën 12 të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 200, datë 12.05.2021, si dhe në Vendimin e tij nr. 238, datë 02.06.2021, “Për përfshirjen e znj. {...}, në procedurat e komandimit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor”, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Lartë Gjyqësor ka ngritur Komisionin Ad Hoc për vlerësimin dhe përzgjedhjen e kandidatit për pozicionin “Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë”.

Bazuar në dokumentacionin e administruar, Komisioni Ad Hoc ka vlerësuar se kandidatja znj. {...}plotëson: Kriteret e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil sipas nenit 21, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ndërsa pozicioni për të cilin është kërkuar komandimi i magjistratit bën pjesë në shërbimin civil; Kriteret e

komandimit sipas pikës 7, të Vendimit nr. 200, datë 02.06.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor; Kriteret preferenciale të komandimit sipas pikës 8, të Vendimit nr. 200, datë 02.06.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në përfundim të vlerësimit, Komisioni Ad Hoc ka përzgjedhur kandidaten znj. {...} për t'u komanduar në pozicionin "Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë", në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Veprimtaria e Komisionit Ad Hoc është dokumentuar në Raportin "Mbi verifikimin, vlerësimin dhe përzgjedhjen e kandidatit për pozicionin e Drejtorit të Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor", ndërsa Kryetarja e Komisionit Ad Hoc, më datë 04.06.2021, i ka përcjellë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Lartë Gjyqësor Memon "Mbi rezultatet e vlerësimit dhe përzgjedhjes së kandidatit, për Drejtor të Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në Këshillin e Lartë Gjyqësor".

Ndërkohë, me Shkresën nr. {...} prot., datë 04.06.2021, bazuar në nenin 78 të Ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, në pikën 5, të nenit 54, të Ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 200, datë 12.05.2021, mbështetur në vlerësimin dhe përzgjedhjen e Komisionit Ad Hoc, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Lartë Gjyqësor i ka kërkuar këtij të fundit komandimin e gjyqtares znj. {...} në pozicionin "Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë", në Këshillin e Lartë Gjyqësor, për një afat deri në tre vjet.

Nisur nga kjo kërkesë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur projektvendimin "Për komandimin e gjyqtares znj. {...} në Këshillin e Lartë Gjyqësor, referuar për këtë përcaktim të neneve 61, 86, shkronja "d" dhe 97, të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, të nenit 54, pika 6, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe të Vendimit të Këshillit nr. 200, datë 12.05.2021, "Për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandimin në Këshillin e Lartë Gjyqësor, kohëzgjatjen, kushtet, kriteret dhe procedurën e komandimit".

Projektvendimi është i strukturuar në 5 pika.

Nëpërmjet pikës 1 të projektvendimit, Këshillit i propozohet të vendosë komandimin e gjyqtarës znj. {...} në pozicionin “Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë”, në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Pika 2 e projektvendimit përcakton periudhën e komandimit, konkretisht “deri në tre vjet”, sikundër edhe datën e fillimit të komandimit, që është lënë e papërcaktuar, kjo në varësi të momentit kur projektvendimi do të shqyrtohej. Përcaktimi në një kohë të mëvonshme i fillimit të efekteve të vendimit të komandimit është bërë me synimin e mosdëmtimit të dhënies së drejtësisë, pra me qëllim që të mundësohet përfundimi nga znj. {...} të çështjeve që ka për gjykim, të cilat janë në përfundim apo në një fazë të avancuar të shqyrtimit gjyqësor. Si datë e mundshme për fillimin e efekteve të vendimit të komandimit, nisur nga ngarkesa e punës së znj. {...}, sipas Shkresën nr. {...} prot., datë 01.06.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, Komisioni ka vlerësuar që ajo duhet të përcaktohet në kufijtë e 10-15 ditëve. Sot, meqë është rasti që po shqyrtohet tashmë projektvendimi, propozohet që si datë e fillimit të komandimit të jetë data 21 qershor 2021.

Në pikën 3 të projektvendimit përcaktohet se komandimi ndërpritet në rastin e verifikimit të ndonjë prej kushteve ndaluese të komandimit, pikërisht ato të përcaktuara në nenin 53, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, sikundër edhe në pikën 6, të Vendimit të Këshillit nr. 200, datë 12.05.2021.

Sipas pikës 4 të projektvendimit, urdhërohet përjashtimi i menjëhershëm i gjyqtarës znj. {...} nga procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, kjo për të evituar ngarkesën e punës së znj. {...} në gjykatë, ndërsa ajo brenda një periudhe të shkurtër kohe, sipas projektvendimit, pritët të fillojë komandimin në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Në pikën 5 të projektvendimit përcaktohet se një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarës së komanduar znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në adresën e saj postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet hyrja e tij në fuqi menjëherë dhe publikimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Jemi dakord me propozimin e ardhur nga Komisioni?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Komandimin e gjyqtares znj. {...} në pozicionin “Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë”, në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

2. Periudha e komandimit është deri në tre vjet dhe fillon më datë 21.06.2021.

3. Komandimi ndërpritet në rastin e verifikimit të ndonjë prej kushteve ndaluese të komandimit.

4. Urdhërohet përjashtimi i menjëhershëm i gjyqtares znj. {...} nga procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier.

5. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares së komanduar znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në adresën e saj postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 8 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2021

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.06.2021)

Pika 9 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i dy projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro):

9.1 “Për caktimin në Skemën e Delegimit të gjyqtarit z. {...}”;

9.2 “Për caktimin e gjyqtarit të Skemës së Delegimit z. {...} në Gjykatën e Apelit Shkodër”.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:05 dhe mbaroi në orën 13:50.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Medi Bici | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 7. Ilir Toska | (anëtar) |

8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
10. *Marçela Shehu* (anëtare)
11. *Erjon Muharremaj* (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Aleksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
5. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
7. *Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

9. Shqyrtimi i dy projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro):

9.1 “Për caktimin në Skemën e Delegimit të gjyqtarit z. {...}”;

9.2 “Për caktimin e gjyqtarit të Skemës së Delegimit z. {...} në Gjykatën e Apelit Shkodër”.

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen e fundit të rendit të ditës e cila përmban dy projektvendime të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës dhe që do relatohen nga zoti Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është paraqitur një shkresë me nr. {...}, datë 30.04.2021, të magjistratit {...}, i cili ka shprehur interes për të shërbyer në skemën e delegimit të ngritur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky magjistrat ka filluar detyrën dhe funksionin si gjyqtar Vendimin nr. 6, datë 30.08.1995, të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, dhe me vendimin nr. 15 të po këtij institucioni datë 30.05.1998, ai është transferuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, ku vazhdon dhe aktualisht.

Instituti i skemës së delegimit rregullohet nga neni 45 i ligjit 96/2016 gjithashtu edhe nga akti normativ i KLGJ-së, konkretisht rregullorja e miratuar me vendimin nr. 22, datë 07.02.2019 “Për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit” dhe pikërisht duke analizuar kriteret që janë vendosur në ligj dhe në këtë akt normativ dhe aktet që janë të depozituara në lidhje me këtë magjistrat, rezulton që gjyqtari ka dhënë pëlqim për t’u komanduar në skemën e delegimit; ka më shumë se 1 vit përvojë në funksion; nuk ndodhet nën efektet e një mase disiplinore, që do ta përjashtonte në përfshirjen e skemën e delegimit; nuk ushtron funksionin e Kryetarit apo Zëvendëskryetarit; është i caktuar në mënyrë të përhershme në një gjykatë ku komandimi nuk cenon funksionalitetin e saj, pasi rezulton që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka 13 gjyqtarë ndërsa organika është 14; nuk rezulton të jetë duke ushtruar funksionin e tij si gjyqtar në një gjykatë tjetër për shkak të transferimit të përkohshëm me ose pa pëlqim.

Kështu që në këto kushte, Komisioni propozon projektvendimin përkatës, në dispozitivin e të cilit do të gjeni:

1. Pranimin e kërkesës së gjyqtarit z. {...}.
2. Caktimin e gjyqtarit z. {...} në skemën e delegimit të ngritur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, me afat deri në një vit, që mund të ndërpritet ose zgjatet në varësi të rrethanave.
3. Përjashtimin e gjyqtarit z. {...} nga procedurat e shortit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

4. Gjyqtari i skemës së delegimit, z. {...}, ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet që ka në shqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, për të cilat ka përfunduar apo është në përfundim të hetimit gjyqësor.

5. Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data e njoftimit.

6. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Jemi dakord me projekt-aktin e propozuar?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Dakord.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Pranimin e kërkesës së gjyqtarit z. {...}.

2. Caktimin e gjyqtarit z. {...} në skemën e delegimit të ngritur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, me afat deri në një vit, që mund të ndërpritet ose zgjatet në varësi të rrethanave.

3. Përjashtimin e gjyqtarit z. {...} nga procedurat e shortit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

4. Gjyqtari i skemës së delegimit, z. {...}, ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet që ka në shqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, për të cilat ka përfunduar apo është në përfundim të hetimit gjyqësor.

5. Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data e njoftimit.

6. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i dytë që ka të bëjë me caktimin e gjyqtarit {...} i Skemës së Delegimit. Sërish fjala për zotin Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Siç jeni në dijeni, Gjykata e Apelit Shkodër ka qenë gjithmonë një gjykatë në nevojë për shkak të vakancave që ka. Në organikën e saj duhet të kishte 10 gjyqtarë, ndërkohë që fiktivisht janë 4 dhe për shkak të këtyre vakancave dhe ngarkesës së madhe që ajo ka, vazhdimisht ka pasur nevojë për gjyqtarë të cilët nga ana e Komisionit është adresuar por edhe Këshilli ka vendosur duke operuar nëpërmjet caktimit të gjyqtarëve në gjykata të tjera të apelit.

Gjithashtu për t’i ardhur në ndihmë nevojave dhe për të zgjidhur problemet, afatet e gjykimit të cilat për shkak të vakancave vijnë të zgjaten, nga ana e Komisionit është parashikuar dhe ju propozohet që në skemën e delegimit ku është përfshirë dhe zoti {...}, ai të përfshihet posaçërisht në Gjykatën e Apelit Shkodër, ku të ushtrojë funksionin si gjyqtar.

Lidhur me këtë, vlen të theksohet që gjyqtari {...} ka një përvojë profesionale 25-vjeçare, pra përfshihet përvoja minimale profesionale që kërkon neni 47, pika 4 e ligjit 96/2016 për Statusin për ngritjen në detyrë në gjykatën e apelit, rrethanë kjo që i jep të drejtë Këshillit ta caktojë atë në gjykatën e apelit për periudhën e komandimit në skemën e delegimit, sikurse përcaktohet në shkronjën “a”, pika 4, të nenit 45, të këtij ligji, ku

përcaktohet se: “4. Këshilli cakton magistratin në skemën e delegimit në bazë të nevojave të një gjykate ose prokurorie: a) në çdo pozicion të njëjtit nivel ose të një niveli tjetër, për të cilin magjistrati përmbush kërkesat; ...”

Pra duke konsideruar që gjyqtari {...} plotëson këto kritere, nga ana e Komisionit është propozuar projektvendimi, ku ju sugjerohet si më poshtë:

1. Gjyqtari i skemës së delegimit z. {...} caktohet për të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit Shkodër për periudhën deri më datë 09.06.2022.

2. Gjyqtari i skemës së delegimit z. {...} përjashtohet nga procedurat e shortit në Gjykatën e Apelit Shkodër për periudhën deri më datë 04.07.2021, me përjashtim të çështjeve në të cilat gjyqtarët e kësaj gjykate do të kenë pengesë ligjore për gjykimin e tyre.

3. Ngarkohet Kryetari i Gjykatës së Apelit Shkodër për përcaktimin e numrit dhe të rrethit të çështjeve që do të rindahen me short, me qëllim që ngarkesa e punës së gjyqtarit {...}, për aq sa është e mundur, të jetë jo më të lartë se numri mesatar i çështjeve për gjyqtar të asaj gjykate, si dhe të përfshijë çështje të të gjitha kategorive dhe të së njëjtës vjetërsi sipas kohës së regjistrimit të tyre, për të cilat nuk janë kryer veprime apo shpallur për gjykim nga gjyqtarët relatorë.

4. Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data e njoftimit.

5. Efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

6. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit të skemës së delegimit, z. {...}, sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Kemi ndonjë diskutim lidhur me projekt-aktin?

Alban, do i vëmë datën e ditës së mbledhjes?

Alban Toro: Po!

Naureda Llagami: Atëherë, në votim të projekt-aktit?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Gjyqtari i skemës së delegimit z. {...} caktohet për të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit Shkodër për periudhën deri më datë 09.06.2022.

2. Gjyqtari i skemës së delegimit z. {...} përjashtohet nga procedurat e shortit në Gjykatën e Apelit Shkodër për periudhën deri më datë 09.06.2021, me përjashtim të çështjeve në të cilat gjyqtarët e kësaj gjykate do të kenë pengesë ligjore për gjykimin e tyre.

3. Ngarkohet Kryetari i Gjykatës së Apelit Shkodër për përcaktimin e numrit dhe të rrethit të çështjeve që do të rindahen me short, me qëllim që ngarkesa e punës së gjyqtarit {...}, për aq sa është e mundur, të jetë jo më të lartë se numri mesatar i çështjeve për gjyqtar të asaj gjykate, si dhe të përfshijë çështje të të gjitha kategorive dhe të së njëjtës vjetërsi sipas kohës së regjistrimit të tyre, për të cilat nuk janë kryer veprime apo shpallur për gjykim nga gjyqtarët relatorë.

4. Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data e njoftimit.

5. Efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

6. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit të skemës së delegimit, z. {...}, sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Apelit Shkodër.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ilir Toska: Më fal Kryetare, se kishte një pasaktësi tek pika 2 për datën.

Albani propozoi një datë konkrete, jo datën e sotme. Data e sotme është tek pika 1. Albani ta saktësojë datën që propozoi.

Alban Toro: Pika 2 është data 04.07.2021.

Pra, gjyqtari i skemës së delegimit z. {...} përjashtohet nga procedurat e shortit në Gjykatën e Apelit Shkodër për periudhën deri më datë 04.07.2021, me përjashtim të çështjeve në të cilat gjyqtarët e kësaj gjykate do të kenë pengesë ligjore për gjykimin e tyre.

Naureda Llagami: Dakord.

Nëse nuk kemi ndonjë gjë tjetër, po e mbyllim mbledhjen.

Punë të mbarë!

* * *

(Pika 9 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor